

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7329 E shtunë 21 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ZOJE JAKAJ

Të dashurosh dhe të dish të dash në mënyrë të tillë që të mos ndjekësh rrugën e gabuar në jetë. Po e nis këtë shkrim me shprehjen që më dhemb ...
Vijon në faqen 20

Sa shumë urrejtje e sa pak dashuri mes nesh



Opinion

Ditës

Nga JULIAN ZYLA

Mëqë asnjë nga deputetët e PS-së nuk ju ka ftuar sot, po jua jap unë një kafe", u duk të mëshironte Blendi Fevziu, deputetin Saimir Tahiri në fund ...
Vijon në faqen 21

"Tahiri", si shembull i një manie të opozitës



ALUIZNI: Ja kush përfiton tapitë Legalizimet, 2000 personat që kanë gati lejet e banesave, lista

Pas ligjërimit të shtëpive dosja i kalon Hipotekës nga vetë institucioni

Nga ORNELA MANJANI

ALUIZNI publikon listën me 2000 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në Elbasan. Drejtoria e ALUIZNI-t të Elbasanit njofton qytetarët se duhet ...
Në faqet 9-11

ISH-MINISTRI: ESTRADË! DO TE PRES DERI NE FUND, KRYEMINISTRI: S'KA PROVA

ARRESTIMI I TAHIRIT FUT NE SHERR PS-NE DHE PD-NE

Pse u përplasën Fatmir Xhafaj dhe Adriatik Llalla... Të gjitha debatet në Komisionin e Mandateve. 400 faqe të reja me prova nga Italia në prokurori



(Në foto) Ish ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, avokati i tij, Artan Hajdari dhe prokurorët, Besnim Hajdarmataj e Elizabeta Imeraj
Në faqet 2-5

ROLI I NEZIR SEITAJ

Anëtarët e grupit të Habilajve, familjarët: S'e dimë ku ndodhen
Në faqen 7

DEKLARATA E PRESIDENTIT

Kufiri me Greqinë, Rama: Gjykata mbrojtëse e sovranitetit
Në faqen 6

LIDHJA ME DETYREN

Kërcënohet, letër dhe tritol për avokaten, Zyba: S'kam konflikte
Në faqen 8

REPORTAZH

Dalin në dritë rrënojat e shekullit të V e varrezat e Neolitit
Në faqen 19

AFATET E REJA



Lotaria Amerikane, ambasada: Problemet me faqen, si të regjistroheni sërish
Në faqen 12


BLUE TOOTH

Klaudia Kalia: Ju rrëfej skandalet që ndodhin në konkurse

Kristin Prengaj shtatzënë, fejesa intime në Greqi

Enca festë erotike për ditëlindjen, nga kërcimi te puthja me femër

Bukurshja e ekranit ia b'doli që në pak kohë të shndërrohej në kryefjalën e mediave. Foto seksi, lidhje të përfolura, pushime luksoze ishin shpesh lajmet që na vinin prej saj. Flasin për Kristin Prengajn, e cila prej kohësh u mungon rrjeteve sociale, por edhe publikut. Ashtu siç



"Summer Pages" raporto i gjatë verës, modelja po shijonte dashurinë në krahët e partnerit biznesmen. Siç kemi bërë me dije, modelja po bashkëjetonte me të dashurin e saj në Athinë, ku djaloshi fatlum ka disa biznese. Por, duket se një tjetër ...
Suplement

KESHILLI I MANDATEVE DEBATET

Darina Tanushi

Këshilli i Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores do të vijojë sot në orën 10:00 seancën e diskutimeve për heqjen ose jo të imunitetit të deputetit socialist, Saimir Tahiri. Pas shumë debateve dhe një seance të gjatë dje, Kryetari i Kuvendit dhe njëkohësisht, kreu i Këshillit të Mandateve dhe Rregullores, Gramoz Ruçi vendosi shtyrjen e seancës. Burimet nga Prokuroria bënë me dije se në këtë institucion kanë mbërritur rreth 400 faqe të tjera me prova dhe fakte që mbështesin dy akuzat e ngritura nga Prokuroria për ish-ministrin Tahiri. Ne keto faqe thuhet se ka prova për

Kreu i Kuvendit shtyn vendimin. 400 faqe të reja me prova nga Italia në prokurori

Përballja në Këshillin e Mandateve, prokurorët: Tahiri, në grupin kriminal

PS: Ku i keni provat? PD: Shtyrja, skandal



DEKLARATAT



TAKIMI

Në orën 10:30 të paradites së djeshme, kryeministri Edi Rama mbledhi anëtarët e PS të Këshillit të Mandateve në zyrën e tij në Kryeministri. Në këtë takim mori pjesë edhe Fatmir Xhafraj. Mbledhja u bë pak para se të fillonte keshilli i mandateve.



ISH-MINISTRI

Ish-ministri i Brendshëm priti dje për gati 2 orë e gjysmë për t'u kujtuar se ishte ai dhe emri i tij që diskutohet, ai shkroi emrin dhe mbiemrin e tij në letër dhe e vuri para vetes mbi tryezë, në mënyrë që ajo të lexohej nga anëtarët e keshillit.



shtetit". Ndërsa vetë Tahiri tha se, "Në 2015-ën ka bërë paktin me prokurori ku ndër Habilaj pas denoncimeve në media se automjeti tip "Audi" i shtrugua nga ai po përdorej për trafik droge, por prokuroria ka mbyllur çështjen". Në fund,

kur Kreu i Kuvendit kërkoi shtyrjen e keshillit për sot, deputeti i PD-së, Alibeaj u shpreh se "Kjo është alibi banale për të shtyrë. Boli kemi dhënë kohë për prishjen e provave". Deputeti i PS-së, Blendi Çuçi i duhet dhënë e drejta deputetit të mbrohet, pasi janë brenda afateve.

DEBATET

Hajdarmataj: Prokuroria gjatë vitit 2016, duke u bazuar nga disa informacione, kemi filluar procedime penale kryesisht në lidhje me veprat penale të kultivimit e lëndëve narkotike, ato të procedim nr. 134 të vitit 2016, ku një grup personash Moisi Habilaj dhe Artan Habilaj si dhe punonjës policie ishin të angazhuar në vepra penale të kultivimit. E zhvillorin në disa fshatra të Vlorës. Kishte dhe punonjës policie që siguronin kushte dhe mundësitë, na ka rezultuar nga verifikimet në terren. Me metoda speciale të hetimit. Kemi arritur të mbleidhim prova se një grup personash për të cilat prokuroria ka marrë masa shtrënguese, ku përfshiheshin edhe 2 policë të drejtorisë Vlorë. Kemi bërë ndarjen e këtij procedimi pasi kishim prova të plota dhe kemi vazhduar hetimin pasi na rezultoi se të përfshirë ishin edhe vëllezërit Habilaj.

Kemi regjistruar procedimin edhe për deputetin Saimir Tahiri. Rezultonte që kishte biseda komprometuese në lidhje me Tahirin, qoftë për pjesëmarrjen, por edhe për dhënien dhe marrjen e, rezultat që jemi pranë veprës penale të korrupsionit pasiv.

Kemi bërë verifikime që as italianët, as grekët nuk i kanë, që përfornojnë bindjen dhe dyshimin që realisht ato biseda sipërputhen, që mund të them s'përkohësisht. Në

TAULANT BALLA

Kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroi dje, pas mbylljes së ditës së parë të Këshillit të Mandateve: "Ne jemi pro drejtësisë! Drejtësi për këdo! Drejtësi deri në fund! Vetëm me dyshime të ngritura mbi prova, jo mbi thashetheme gazetash".

sistemin TIMS: Deputeti Saimir Tahiri në 2013, dhe 5 i 11 2013, duke pasur në pronësi një automjet të tij, e kishte shtruar Artan Habilaj. Na ka rezultuar se ky automjet është përdorur dhe ripërdorur 2013-2014. Deputeti ka udhëtuar kryesisht në Greqi, në një moment të caktuar, kur Tahiri ndodhej në Greqi, automjeti është dërguar nga njëri prej vëllezërve Habilaj dhe në këtim është kthyer deputeti Tahiri. 2014 deri në prill 2017, asnjëherë nga Policia e Shtetit nuk është referuar një material për aktivitetin kriminal të këtyre personave, ndërkohë që prokuroria italiane po zhvillohet hetime ku ishte kapur edhe lëndë narkotike.

Arrestin e jep gjykata, kemi ardhur për të kërkuar këtu heqjen e një imuniteti, deputeti mund të jetë i ekspozuar ndaj një mase sigurie, ose heqje lirie nga gjykata.

Manja: Kam një pyetje për prokurorin se nuk e kuptova tani. I kërkohet këtyrë Këshilli heqje e imunitetit apo leja për kontroll banase dhe personal.

Hajdarmataj: Ne kemi kërkuar autorizim për arrestimin dhe heqjen e lirisë së deputetit dhe njëkohësisht për kryerjen e kontrollit të vendeve dhe banesave që ka në dispozicion. Kemi shkëmbyer letër-porosi me autoritetet italiane, e kemi marrë. Jemi në pritje në çdo moment. Duke u ndodhur para gjithë këtyre situatave, ne kemi kërkuar autorizimin për heqjen e imunitetit dhe arrestimin, njëkohësisht për kontrollin.

Nuk kemi ardhur për marrjen e arrestit, por që ju të na hapni rrugë për procedurat ligjore që i takojnë prokurorisë dhe gjykatës.

Alibeaj: Është regjistruar në regjistratë të procedimit Tahiri?

Hajdarmataj: Kemi regjistruar një procedim penal kryesisht me nr.313 dhe emrat e të gjithë personave. 17.10.2017. Bashkë me këta personave kemi regjistruar

edhe emrin e Saimir Tahirit. **Alibeaj: Për mendimin tuaj, bazuar në provat që keni, ekziston dyshimi që Saimir Tahiri të ikë nga vendi, të prishë provat?**

Hajdarmataj: Sigurisht që ne kemi dyshimin që mund të jemi përpapa këtyre rasteve. Unë jo pa dashje bëra një prezantim të përgjithshëm, ne kemi filluar një hetim duke e mbajtur në sekret të plotë edhe me prova hetimore që s'kemi pasur mundësi t'i kryejmë në terren. Z.Tahiri atëherë ka qenë ministër i Brendshëm, patjetër që me marrjen në dënim mund të ndodhë t'i shmanget hetimit.

Manja: Ju në 18 tetor 2017 me letër-porosi prokurorisë italiane, cilin keni në dorë, atë të gazetës apo atë në rrugë zyrtare?

Hajdarmataj: Material që është administruar në prokurori në 19.10.2017. I gjithi ka qenë në gjuhën italiane. Po vazhdojmë përkthimin e tij. Kemi përkthyer momentet ku implikohet Saimir Tahiri se jo i gjithë mund t'u interesojë të diskutohet këtu. Materiali që disponojmë ka ardhur në rrugë zyrtare.

Manja: A mendoni ju, apo gjykon ju se një procedim penal i filluar në 17.10.2017 me një opinion gazete dhe lajm portaleshme përbën bazën e mjaftueshme për të çuar para dyerve të burgut një deputet apo çdo qytetar?

Imeraj: Në funksion të asaj që pyetët nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova. Dalja nga media dhe bërja publike e disa informacioneve ka shërbyer si element specifik për fillimin e ndjekjes penale. Duke qenë se emri i tij ishte i njohur, është bërë fillimi i hetimit në emrin e tij. Ka pasur në hetim disa procedime nr. 134 në 2016 dhe nr.164 në 2017. 18.10.2017 është sekuestruar lëndë narkotike, ku është arrestuar Armand Koçerri. Detaje që vinë nga bisedat telefonike, krijohet baza e mjaftueshme e të dhënave që personi në hetim të dyshohet se ka kryer ve-



Mbledhja e djeshme e Këshillit të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores

për penale. A ekziston në rastin konkret rreziku i ikjes? Ekziston shmangia nga gjykimi.

Hallimi: Të dashur kolegë gjyqi që po i bëni prokurorisë nuk e ndihmoni Tahirin se ka avokat vetë, e dëmtoni. Nuk ka ndodhur kjo ndonjëherë të kryqëzohet prokurori! Ata janë par excellence, po i përgjigjen çdo pyetje. Z.prokuror keni ndonjë ngut ju se mos prishen provat? Ne e shtymë se i dhënë 24 orë kohë. E vazhdojmë nesër, pasnesër, është rasti i parë që kemi prokurorë për Krime të Rënda. Ka ndonjë ngut se duhet të vendosim shtepi ne?!

Imeraj: Ne squarum pozicionin tonë, bazën ligjore duke argumentuar edhe parashikimet e neneve. Nuk duhet të pyetet prokurori a keni ngutje. Prokuroria duhet të veprojë në moment. Hallimi: E doni sot, nesër, pasnesër apo pas 1 javë?

Ruçi: Nuk është puna e prokurorisë se kur e duan... **Hajdarmataj:** Është në diskrecionin e komisionit se kur.

Hallimi: A ka rrezik të prishen apo dëmtohen prova gjatë këtyre orëve, ditëve?

Imeraj: Personi ka qenë ish-ministër i Brendshëm, duke qenë se janë në hetim edhe persona të tjerë që janë në detyrë, si rezultat i lidhjeve ekzistuar rreziku.

Hallimi: Ju keni pasur informacion se grupi i Habilajve ka bërë namin këto 4 vjet?

Hajdarmataj: Deri në vitin 2016, nuk ka ardhur ndonjëherë material që nga viti 2013, në momentin që është regjistruar procedimi në Itali ne nuk kemi asnjë material. Në 2016 Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin nr.134. Pastaj në 2016, nga fundi i muajit prill ka ardhur vetëm një material në ngarkim që fliste për një aktivitet të shtetasve Habilaj, i cili është bërë pjesë e hetimit për procedimin 2016.

Hysli: Pyetjen e kam për znj.prokurorë. Në faqen 4 thuhet se z.Tahiri ka përdorur automjetin e tij në 4 raste, në këto udhëtime që personi në hetim ka qenë i shoqëruar nga subjekte

ÇESHTJA "TAHIRI" REAGIMET

Adriatik Llalla: Alarmante, situata kriminale në Elbasan, Vlorë e Lushnjë

Çështja "Tahiri" përplas ministrin e Brendshëm me kryeprokurorin

Xhafaj: Prokuroria po përdoret politikisht, s'ka prova. Llalla: Skam faj që Xhafaj nuk njeh ligjin



Denoncimi i kryetarit të PD-së për heqjen e gomones nga porti që sipas denoncuesit është e Saimir Tahirit

Xhensila Kodra

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj akuzoi dje prokurorinë se po përdoret politikisht për çështjen "Tahiri". Sipas tij, duke folur me gjuhën e juristit dhe ligjvënësit, Xhafaj theksoi se prokuroria nuk ka prova që mund të çojnë në arrestimin e paraardhësit të tij, Saimir Tahirit. Ai shkoi edhe më tej, kur dha një provë tjetër, sipas së cilit ka pasur një bashkëpunim të prokurorisë me opozitën, duke iu referuar videos së publikuar në rrjetin social nga ish-kryeministri Sali Berisha, në mes të operacionit antidrogë në Babicë, ku u sekuestrua sasia prej rreth 4 tonë kanabis. Por, menjëherë pas akuzave tepër të rënda të ngritura nga ministri, i menjëhershëm ishte edhe reagimi i kryeprokurorit Adriatik Llalla. Ky i fundit në një prononcim për mediat tha se ministri Xhafaj duhet të jetë i informuar për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në vend. Po ashtu, ai theksoi se situata kriminale në vendin tonë është përhapur në mënyrë alarmante, e sidomos në 3 qytete, konkretisht në Elbasan, në Vlorë dhe në qytetin e Lushnjës. Replikat në distancë u shkëmbyen vetëm një orë përpara se Komisioni i Imuniteteve dhe Mandateve të merrte në shqyrtim kërkesën e prokurorisë për autorizim për arrestimin e deputetit socialist, Saimir Tahiri.



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj



Kryeprokurori Adriatik Llalla

disponon prova të tjera, mbetet për t'u parë dhe për t'u gjykuar. Po flasim për një situatë faktike", u shpreh dje

ministri Xhafaj në lidhje me kërkesën e prokurorisë për arrestimin e ish-ministrit Tahiri. "Rasti 'Habilaj' ka

disa vite që trajtohet, ka dy referime nga Policia e Shtetit në prokurori për këtë çështje dhe ka pak ose aspak

veprime nga prokuroria në këtë çështje të referuar nga policia", tha ai.

PRONONCIMI I ADRIATIK LLALLËS

"Ish-kryetari i reformës në drejtësi, ministri i Brendshëm, nëse nuk është i qartë për ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Penale, besoj se është problematikë e tij. Prokuroria shqiptare po ndjek me vëmendje të veçantë hetimin e të gjitha rasteve të kriminalitetit në vend. Situata është e tensionuar. Krimi i shpërndarë në mënyrën ga-

loponde në tërë territorin e vendit është shqetësues. Situata në Elbasan, Vlorë, Lushnjë është problematike. Detyra jonë është t'i hetojmë të gjitha këto raste dhe të gjithë krerët dhe drejtuesit e policisë, që me veprimet e tyre apo mosveprimet kanë lejuar këto veprimtari. Apo që nuk kanë arrestuar kriminalët, të mos themi që disa drejtues mund të jenë edhe bashkëpunëtorë me ta", u shpreh kryeprokurori Llalla, pas akuzave të bëra nga ministri Xhafaj.

"Në Tiranë ekspertët e FBI, do vendosen në MB"

Xhafaj takohet me Donald Lu dhe Vlahutin për luftën kundër krimit të organizuar

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj është takuar ditën e djeshme me ambasadorin amerikan Donald Lu dhe ambasadorin e Bashkimit Europian Romana Vlahutin. Mësohet se ministri Xhafaj dhe dy diplomatët diskutuan për strategjinë e re në luftën kundër krimit të organizuar. Këtë gjë e ka konfirmuar vetë ministri i Brendshëm në një postim në rrjetet sociale. "Takim konstruktiv me ambasadorët Lu dhe Vlahutin. Mësohet se teknikë dhe financiare për Strategjinë e Re në luftë kundër krimit të organizuar. Një lajm i shumë pritur nga ambasadori amerikan: Shumë shpejt mbërrin në Tiranë ekspertët e FBI që do vendosen në MB. Faleminderit, SHBA"-shkruan ministri Xhafaj. Mësohet se takimi mes tyre zgjati për rreth



90 minuta, ndërsa u diskutua edhe për rastet "Tahiri" dhe "Habilaj". Mësohet se në



muajin nëntor pritet të mbërrin në Shqipëri agentët amerikanë të FBI-së.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandën për shitjen e pasurisë së pallogjishme 7% pjesë ideale taksesë e dëbatorit Hysen Mehmet Kaco, tek pasuria ka përfshirë dhe një apartament, me numër pasarie 489+1.3, Vullmi 11, Faqe 23 ne Zonen Kadastrale Nr.8130, me sipërfaqe prej 78.94 m², e ndodhur ne Tirane, Adresa: Rr Oemal Stafa, Shkalla 1, Kati 2, Ap. 3, për shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Refik Cepeli, për shumën 10'400. Usd dhe 139742 lëka.
Ankandë zhvillohet ne te cilin filloj ankandë ishtio ne shumën 1480125njo milion e katordjind e tetedjete mijë e njeqind e njezelo e peselëkë, e percaktuar ne raport vleresimin e bore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin Nr.5812 date 27.06.2017.
Ankandë zhvillohet ne date 02.11.2017, ora 16:00 ne zyren e permbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Topçani, Qendra Torre Drin, K1.2, Nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email : ermirgodaj@zyraperambarimit.com.

Ambasadori hungarez: Ne nuk japim zgjidhje, po monitorojmë

Çështja "Tahiri" ka mbërritur deri në selitë e diplomacive të larta, të cilat po e ndjekin hap pas hapi këtë proces. Këtë gjë po bën edhe Hungaria, e konfirmuar kjo nga ambasadori i akredituar në vendin tonë Antal Heizer. "Kriminaliteti është një nga 5 hapat e mëdhenj që duhet të marrë politika shqiptare. Po e ndjekim nga afër çfarë po ndodh, por është detyrë e vendit tuaj që të marrë përsipër përgjegjësitë e të luftojë në këtë drejtim. Nuk është detyra jonë të ofrojmë zgjidhje, kjo ju takon ju ta bëni", - u shpreh Antal Heizer. Një pikë të fortë që e quan rrugë pa kthim, ai sheh vetingun, për të cilin ndonëse vlerëson hapat e hedhur, thekson në të njëjtën kohë se ka ende punë për të bërë. "Natyrisht do të vlerësoja hapat e ndërmarrë në drejtim të sistemit të vetingut, i cili është një proces. Natyrisht nuk mund të arrihen suksese në këtë drejtim të menjëhershme, pasi edhe ai kërkon kohën e vet, por mund të them se ka filluar mirë. Sistemi i monitorimit ndërkombëtar është në Shqipëri, por sa i përket kësaj, apo kërkesave nga opozita e faktorë të tjerë që van proces të thelluar, kjo do të ndodhë. Vetingu do kohën e vet, por do të kryhet. Nuk është dëshirë e ndërkombëtareve, por duhet dhe do të bëhet. Duhet t'ju informojë edhe ju si qytetarë dhe klasës së ndershme politike", thotë ai. Deklaratat ai i bëri në përkuajtimit të ditës së Hungarisë, pranë memorialit që përkuajton këtë revolucion në Shkodër.





Shtyrja për Tahirin, kreu i PD: Ministri levë e kryeministrit, të japin dorëheqjen

Basha: Rama-Xhafaj morën mln euro ryshfet, po blihet e vërteta

"Po vjen ora të marrim në dorë fatet tona"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, reagoi ashpër pas shtyrjes së mbledhjes së Këshillit të Mandateve dhe Imuniteteve për marrjen e vendimit për imunitetin e deputetit socialist, Saimir Tahiri, për të cilin prokuroria ka kërkuar autorizim për arrestim si i dyshuar për lidhje me trafikun ndërkombëtar të drogës. Basha akuzoi se, "këto 24 orë do blihet e vërteta". Në një situatë të tillë, kreu i PD-së u bëri thirrje shqiptarëve që të marrin në dorë fatet e tyre për të rrëzuar kupolën e pushtetit mafioz. "Opozita e bashkuar tashmë e ka marrë një vendim, largimi i Edi Ramës, një qeveri antimafia, është e vetmja rrugë që do të garantojë zbatimin e drejtësisë në vend, që të vendosë rendin dhe sigurinë. Mënyrat për të arritur këtë, opionet për të arritur deri aty po zvogëlohen me shpejtësi të madhe. I bëj thirrje çdo qytetar, që deri më sot ka qenë në dyshim apo skeptik sa u përket mundësive dhe gatishmërisë së Edi Ramës për të luftuar krimin, që pas shfaqjes së sotme t'i bashkohet qëndrimin tonë si opozitë... Po vjen ora të marrim në dorë fatet tona, vendin nuk mund t'ia lëmë kupolës mafioze, në dorë të narkoshtetit. Po vjen ora që të gjithë së bashku të ndërmarrim hapat e duhur për t'i treguar vendin, për ta larguar nga qeveria dhe për t'i hapur rrugë drejtësisë për Saimir Tahirin, Fatmir Xhafajn, Edi Ramën dhe kupolën mafioze", deklaroi z.Basha. Sipas tij, me mbledhjen në Këshillin e Mandateve dhe Imuniteteve, Edi Rama u tregoi shqiptarëve se është në krah të Saimir Tahirin dhe se e vërteta e përbashkët që i lidh dhe inkriminon është shumë herë më e fortë se retorika e tij për të bërë drejtësi. "Askush nuk kuron prova për t'i hequr një privilegj Saimir Tahirin dhe për ta vënë atë si të barabartë me qytetarët e tjerë para drejtësisë. Provat administrohen nga gjykata. Faktet e bëra publike para shqiptarëve tregojnë qartë se parlamenti nuk ka rrugë tjetër, përveçse t'i heqë një orë e më shumë imunitetin Saimir Tahirin, që të vendoset para drejtësisë", u shpreh z.Ba-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

AKUZA

"Rama ka futur njerëz për mospagesë dritash në burg ku futur në burg qytetarë të varfër. Dhe do të mbajë të lirë bashkëpunëtorin e tij dhe të krimin të organizuar, të kapur në flagrancë për trafik droge. Ky është narkoshteti. Kjo duhet të marrë fund", tha Basha.

Berisha: Personat që po "kursen" Rama me mbrojtjen e Tahirin

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje përpjekjet e kryeministrit Edi Rama për të shpëtuar Saimir Tahirin nga arrestimi. Sipas tij, Rama po e mbron Tahirin se nuk do të dalin dosjet e vëllait të tij, Olsi, por edhe të vëllait të ministrit Xhafaj. "Noriega urdhëron deputetët mafiozë të tij të mbrojnë Saje qorrin dhe të hedhin poshtë me vota kërkesën e prokurorisë! Pas kërcënimeve të banditit Saje qorri ndaj Ramës, me dosjen e Xibrakës për vëlla Olsin, që e kanë edhe shërbimet partnere dhe afarave të tjera të tij dhe kërcënimeve të Fatmir Xhafajt me dosjen e Agron Xhafajt, e cila nxin kokë e këmbë Fatmirin, Noriega në panik vendosi mbrojtjen me çdo çmim të Saje qorrit, në fakt të vetes së tij dhe vëllaçko Olsit, Xhafajt dhe Agronit të tij, pasi dosjet e tyre në shërbimet partnere janë shumë më të rënda se sa dosja e Saje qorrit! Deputetët e mazhorancës së krimin janë urdhëruar të mbrojnë krimin dhe të kryejnë krimin e rëndë antikushitetues të bllokimit të drejtësisë! Në një tjetër reagim, Berisha shprehet se kryeministri Edi Rama ka nisur në Itali për negociata sekretarin e tij Engjëll Agaçi për të shpëtuar lëkurën. "Noriega nis me urgjencë në Itali sekretarin e përgjithshëm të mafies shtetërore, Don Agaçin, për negociata për të shpëtuar lëkurën e tij!", shkruan Berisha.



"Vendimi me votë, së paku 6 vota nga këshilli"

Shtyrja për Tahirin, Bylykbashi: Ndjekje penale për Ruçin

Deputeti PD, Oerd Bylykbashi akuzoi dje se kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi dhe mazhoranca po shkelin Kushtetutën për të mbrojtur Saimir Tahirin. Ai i bëri thirrje Ruçit që ose të autorizojë arrestimin e Tahirin, ose në të kundërt nëse mendon se akuzat cenon mazhorancën socialiste, të votojë kundër. Bylykbashi kërkon nga prokuroria që të fillojë ndjekjen penale ndaj Ruçit për pengim të hetimeve. Bylykbashi shkruan në 'FB' se kërkesa e Tahirin për shtyrje duhet vendosur me votë, së paku 6 vota nga këshilli. "Prokuroria duhet të fillojë ndjekjen penale ndaj Gramoz Ruçit për pengim të hetimeve. Me vonesat e tij dhe me ndërprerjen e shtyrjen e paligjshme të mbledhjes sot, ai po krijon mundësi të prishen provat. Kryetari i Kuvendit bën vetëm thirrjen e Këshillit për Mandatet, Rregulloren dhe Imunitetin. Këshilli ka 5 anëtarë të mazhorancës dhe 5 të opozitës. Kryetari i Kuvendit nuk ka asnjë kompetencë procedurale dhe as vendim-marrëse (Neni 13, pika 3 e Rregullores së Kuvendit). Kërkesa e Tahirin për shtyrje duhet vendosur me votë, së paku 6 vota nga këshilli. Dhe PS ka vetëm 5 anëtarë. Pra, kërkesa do të rrezohej. Ndërprerja e mbledhjes nga Ruçi thjesht i jep mundësi antiligjit! Po aq sa avokacia që i bënë Tahirin kolegët e tij të një kauze. Asaj të cannabigate", shkruan Bylykbashi në "Facebook".



sha. Ai akuzoi më tej se: "Me qëndrimin e urdhëruar nga Edi Rama, Saimir Tahirin iu blenë edhe 24 orë gjatë të cilave do të shkatërrohen më shumë prova, do të lidhen dhe priten fije mes Saimir Tahirin, Edi Ramës, ministrave të tjerë të kabinetit 'Rama 2', që po figuronin në përgjimet e antimafias. Do të çohen negociatorët dhe emisarët të shantazhuar dhe blerë të vërtetën". Z.Basha apeloj se largimi i Edi Ramës dhe një qeveri antimafia është e vetmja rrugë për të garantuar rendin dhe sigurinë në vend. Më herët në një tjetër dalje para mediave, Basha kërkoi dorëheqjen e menjëhershme të kryeministrit Rama dhe ministrit të Brendshëm, Xhafaj. Basha tha në një dalje urgjente për mediat se Rama dhe Xhafaj janë të zhytur në krim, të kapur nga krimi, kanë përdorur dhe janë përdorur nga krimi. Ai hodhi akuzat të ashpra ndaj dyshes Rama-Xhafaj, teksa tha se kanë marrë miliona euro ryshfet nga fushatat elektorale. "Opozita është në kontakt të vazhdueshëm dhe ka informacione të besueshme që do i vihen publikisht shumë shpejt. Thirrja ime është që Rama dhe Xhafaj të japin sot dorëheqjen dhe t'i lënë vendin një qeverie normale. Këta janë të zhytur në krim, të kapur nga krimi, kanë përdorur krimin dhe janë përdorur prej tij. Kanë marrë miliona euro ryshfete për fushata elektorale. Vëllai i Xhafajt është trafikant i drogës. Asgjë nuk ndryshon, nëse nuk ndryshon kjo kupolë mafioze. Janë bashkë të zhytur në krim, ndaj thirrja ime është për largimin e tyre të menjëhershëm nga detyra dhe vënja para drejtësisë e kokave të mëdha", tha Basha.

Paloka: Rama të bëhet gati për përballje, po i vjen fundi

Opozita po bëhet gati për përballje me kryeministrin Edi Rama. Këtë e paralajmëroi nënkryetari i parlamentit, deputeti i PD-së, Edi Paloka. "Rilindja" në mbrojtje të Tahirin në Komisionin e Mandateve. Sigurisht, me urdhër të Ramës. Megjithatë një ditë më parë deklaruan se do t'i hapnin rrugën procedimit penal, sot po duket qartë se urdhri ka ndryshuar. Kërcënimet e Tahirin ndaj Ramës ('nuk keni parë asgjë akoma') dhe ndaj atyre 'shokëve' që do lejonin arrestimin e tij, duket se e kanë bërë efektin. Sot 'rilindasit' kanë marrë urdhër të mbrojnë jo Tahirin, por Ramën. Ky është akti i fundit. Po u lejua, do të jetë edhe akti i fundit i drejtësisë dhe demokracisë në Shqipëri. Kjo nuk do të lejohet. Rama të bëhet gati për përballje. Përballja do të jetë pa asnjë kompromis dhe do të ketë vetëm një fund, atë të Ramës dhe klikës kriminale.

NJOFTIM

Studio Përmbarrimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e I (Parë) për pasurinë:
 a. Pasuria Nr.20/55+1-17, vol.5, faqe 87, Z.K.8571, e apartament, me sipërfaqe totale 74m2, e ndodhur në Lagjen "Kongresi" Lushnje, çmimi 2.400.000 lekë.
 Ankandi zhvillohet në datë 25.10.2017 në ambientet e Studios Përmbarrimore Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.0682089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com

KUSHTETUESJA PERVJETORI

25-vjetori i Gjykatës, Meta: Gardiane e përjetshëm e Kushtetutës, por përmbushni detyrimet

Valentina Madani

Gjykata Kushtetuese organizoi dje një konferencë me rastin e 25-vjetorit të krijimit. Të pranishëm në këtë takim ishin Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama dhe kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, ndërkohë që munguan ambasadorët Donald Lu dhe Romana Vlahutin. Z.Meta vlerësoi Gjykatën Kushtetuese si modelin demokratik në respektim të të drejtave të njeriut dhe si një institucion i udhëhequr nga praktika e mirë e ndarjes së pushteteve. Ai përmendi se Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar shumë çështje dhe në jo pak raste, ajo arsyeton qartë parimin e ndarjeve të pushteteve. Meta vlerësoi Gjykatën Kushtetuese në konsolidimin e shtetit të së drejtës. Po ashtu, Meta pohoi se Gjykata Kushtetuese ka fituar besimin edhe të gjykatave partnere të vendeve të tjera dhe organizmave ndërkombëtare. Sipas tij, puna e saj është vlerë e shtuar në drejtësinë shqiptare. "Gjykata Kushtetuese, si të gjitha institucionet e tjera përballet me sfidën e implementimit të reformës në drejtësi në drejtim të plotësisht të trupës gjyqësore kushtetuese dhe krijimin e institucioneve të reja, që kanë të bëjnë me qeverisjen në sistem-

Çështja e kufirit me Greqinë, Rama: Gjykata, mbrojtëse e sovranitetit

Sfidat, Dedja: Organizim dhe ristrukturim i institucionit



Konferenca e djeshme e Gjykatës Kushtetuese me rastin e 25-vjetorit të krijimit

in gjyqësor. Është me shumë rëndësi që sistemi gjyqësor në tërësi, përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese të vazhdojë ta përmbushë detyrën sipas ligjit, me integritet, përgjegjësi dhe me të njëjtin përkushtim, pavarë-

sisht nga sfidat", deklaroi z.Meta. Për kryeministrin Edi Rama, ky institucion ka krijuar besueshmëri në sytë e të gjithëve, duke dhënë vendime të paanshme. Kryeministri u ndal edhe në rastin ku kjo gjykatë shqyrtoi

çështjen e kufirit detar me Greqinë. Sipas tij, pavarësisht çështjeve të nxehta, institucionit iu kthehe besueshmëria. "Vend për kritikë me siguri mund të ketë, dhe ka, por nëse ka një institucion të gjyqësorit sh-

AMBASADORET
Gjykata Kushtetuese organizoi dje një konferencë me rastin e 25-vjetorit të krijimit. Ajo çka ra në sy ishte mungesa e ambasadorëve të SHBA dhe BE në vendin tonë, të cilët jemi mësuar t'i shohim në tryeza të tilla. Mësohet një ftesë nga administrata e Gjykatës Kushtetuese u kishte shkruar edhe dy ambasadorëve të rëndësishëm në vend, Donald Lu dhe Romana Vlahutin.

qiptar ku sot mund të hyhet pa të ardhur turp, është pikërisht Gjykata Kushtetuese. Nuk ndodh shpesh në jetën e një institucioni që të fitojë simpati dhe mbështetje popullore, siç ndodh me këtë gjykatë për çështjen

e kufirit", theksoi z.Rama. Kryeministri përmendi edhe presidentin e Komisionit të Venecias si një bashkëpunëtor të çmuar të Gjykatës Kushtetuese. "I pranishëm në takim është edhe një njeri, që emrin e tij e ka të lidhur me historinë e zhvillimeve në Shqipëri, i nderuari Gianni Buquicchio dhe me thënë të drejtën, pavarësisht se në institucionet tona punojmë me partnerë, jam shumë xheloz që punon me Gjykatën Kushtetuese. Jam i bindur se cilldo që është ulur në karrigen e lartë në Gjykatës Kushtetuese do ta dëshmonte pavarësisht faktit që nuk është aspak komode, prania e Komisionit të Venecias e bën shumë më të lehtë këtë detyrë të rëndë. Ju uroj të gjithë atyre që janë të pranishëm dhe që vijnë nga rruga e ndërtimit të mundimshëm të këtij institucioni themelor, çdo të mirë dhe atyre që janë në Gjykatës Kushtetuese çdo sukses në një rrugë të gjatë e të mundimshme për të zbatuar reformën në drejtësi", deklaroi kryeministri. Ndërsa, kryetari i gjykatës, Bashkim Dedja, vuri në dukje se sfida tashmë është organizimi dhe ristrukturimi i institucionit.



Drejhtësia, Meta-Buquicchio: "Venecia", kontribut për konsensusin

Presidenti Ilir Meta priti dje Z.Gianni Buquicchio, president i Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit - Komisioni i Venecias. Meta e falënderoi z.Buquicchio për kontributin e tij personal, por edhe të gjithë anëtarëve të Komisionit të Venecias për ndihmën e dhënë për institucionet shqiptare, veçanërisht për këshillat e vyera në procesin e përmirësimit të paketës së ndryshimeve kushtetuese dhe ligjeve të tjera që shoqëruan reformën në sistemin e drejtësisë. Z.Buquicchio e uroi z.Meta për zgjedhjen në detyrën e Presidentit të Republikës dhe e siguroi se Komisioni i Venecias do të vazhdojë t'i këshillojë institucionet shqiptare në të mirë të përmirësimit të legjislacionit në të gjitha fushat e rëndësishme, me qëllim konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe ushtrimin të demokracisë funksionale nëpërmjet ligjit. Të dy bashkëbiseduesit ndanë mendimet mbi fazën tranzitore aktuale që ndodhet sistemi i drejtësisë, ku si prioritet vlerësoan nisjen nga funksionimi sa më parë të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

Greqia reagoi sërish dje ndaj miratimit një javë më parë nga Parlamenti shqiptar të ligjit për pakicat kombëtare. Ministria e Jashtme greke e quan këtë një hap prapa për minoritetin grek, që është kryesor në Shqipëri. Ky dikaster akuzon qeverinë shqiptare për promovimin që u bën masave për shkatërrimin e pronës së minoritetit grek. "Këto masa merren në kuadër të politikës shqiptare për të çrrënjësuar praninë e helenizimit në Himarë". Greqia ngre dyshimet se ligji i miratuar dhe të gjitha masat në lidhje me minoritetin bëhen qëllimisht për të shmangur vëmendjen e publikut nga çështjet kryesore politike, që janë ngritur për trafikim e drogës. "Ka shumë që e interpretojnë këtë si një akt me qëllim

Minoritetet, MPJ greke akuza qeverisë

"Po çrrënjësojnë praninë e helenizimit në Himarë"



shmangien e vëmendjes së publikut shqiptar nga çështjet kryesore politike që janë ngritur për trafikim e drogës.

IAKUZAT
Ministria e Jashtme greke akuzon qeverinë shqiptare për promovimin që u bën masave për shkatërrimin e pronës së minoritetit grek. "Këto masa merren në kuadër të politikës shqiptare për të çrrënjësuar praninë e helenizimit në Himarë".

Shpresojmë që të mos jetë kështu", shton më tej Ministria e Jashtme greke. Greqia shpreh shqetësimin edhe për

ngjarjet më të fundit në vend, pas arrestimit të trafikantëve në Itali dhe evidentimin e lidhjeve të tyre me ish-ministrin e Brendshëm. "Ministria e Jashtme greke është po aq e shqetësuar nga lidhja e dukshme mes kimit të organizuar dhe skenës politike në Shqipëri, siç tregohet me arrestimin e fundit të kreut të bandës së trafikimit të drogës, i cili rezultoi të jetë i afërm me dikë që deri kohët e fundit ka qenë ministër i rëndësishëm në qeverinë "Rama".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 26.10.2017 ne orën 16.00 ne zyren e perbaruesit gjyqësor privat Irlisa Tereziju PF me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandit per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Aparament" me siperfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adresë Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushë Kruej.Cmimi ne ankand te pare eshte ne vleren 1,945,244.8 (nje milion e nenteqind e dyzet e pese mije e dyqind e dyzet e kater pike tete) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 25.10.2017 ne orën 16.00 ne zyren e perbaruesit gjyqësor privat Irlisa Tereziju PF me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandit per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Aparament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Vajgurore Berat.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,568,000 (nje milion e peseqind e gjashtedhete e tete mije) lekë.

Nezir Seitaj figuron në dosjen e italianëve, siguronte ambientet dhe pjesën logjistike të grupit

Anëtarët e grupit të Habilajve po kërkohen në Shqipëri

Shoqërohen në polici familjarë të tyre: S'kemi dijeni ku ndodhen

Xhensila Kodra

Policia dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda janë duke vijuar operacionin në disa fshatra të Vlorës për të bërë të mundur gjetjen dhe arrestimin e personave të shpallur në kërkim, të cilët janë të përfshirë në trafikun e drogës, të njohur si pjesëtarë të grupit të Habilajve. Mësohet se kërkimet janë përqendruar kryesisht për vënien në pranga të shtetasit Florian Habilaj, por edhe për persona të tjerë, për të cilët tashmë ka një urdhër arresti nga prokuroria italiane. Burimet thonë se për këtë qëllim janë thirrur për t'u marrë në pyetje njerëz që mund të kenë dijeni mbi lëvizjet, apo vendndodhjen e personave të dyshuar, për të cilët ka urdhër arreste. Mësohet se mes personave të shoqëruar kanë qenë edhe të afërmet familjare të tyre, të cilët kanë pohuar se nuk kanë dijeni për lëvizjet e të kërkuarve



I arrestuari, Nezir Seitaj



Florian Habilaj, në kërkim

nga drejtësia italiane. Pyetja e tyre është bërë pasi hetuesit e kësaj dosjeje në vendin tonë kanë dyshime se personat ndaj të cilëve ka urdhër arreste nga prokuroria italiane ndodhen ende në Babicë, apo zona të tjera të Vlorës. Nga kontrollimet e ushtruara dy ditë më parë, policia arrestoi shtetasin Nezir

Seitaj, për të cilin prokuroria italiane e Katanas ka lëshuar një urdhër arresti. Emri i këtij personi shfaqet edhe në dosjen me 416 faqe, e përpiluar nga prokurorët italianë. Po kështu, më 19 tetor, policia arrestoi në Babicë shtetasin Armand Koçerri. Vënia e tij në pranga u bë pasi në banesë u gjetën dhe u

sekuestruan afërsisht 4 tonë kanabis. Kjo sasi lëndë narkotike e sekuestruar, sipas policisë dhe prokurorisë i përket grupit të Habilajve. Ndër-kaq, burime pranë policisë bënë me dije se Seiti është arrestuar në një zonë periferike të qytetit bregdetar, ndërkohë që në dosjen vullminoze prej 417 faqesh, ai

përmendet në disa episode. Nisur nga përgjimet ambientale, por edhe telefonike rezultojnë se Nezar Seiti lëvizte shpesh nga Shqipëria drejt Italisë e anasjellas dhe kishte detyrë të siguronte ambientet dhe pjesën logjistike të grupit. Në një bisedë me një anëtarin tjetër të grupit, Meridian Sulaj në janar të 2017-ës thotë se bashkëpunimi me policinë nuk po shkon mirë. "Nuk i kemi punët mirë me ata të shtetit... e kam telefononin në shtëpi dhe nuk na telefonojnë më ato të degës së brendshme, se unë kështu i quaj ata, dega e brendshme. Kur kalojnë këta të policisë, 'po kalon sigurimi i shtetit', thuhet në bisedë. Operacioni nisi në Vlorë, pas sekuestrimit nga policia italiane në Katania të një sasi të konsiderueshme lëndë narkotike, ndërsa u arrestuan 7 persona, tre shqiptarë mes të cilëve edhe Moisi Habilaj, i cilësuar si koka e grupit kriminal që trafikonte drogë nga Shqipëria drejt Italisë.

Sherri për parkimin, një në pranga, një në kërkim

TIRANË - Policia e Tiranës ka zbardhur sherrin me armë zjarri, që ndodhi pak ditë më parë kur nga dy automjete u qëllua me armë zjarri në rrugën "Mujo Ulqinaku". Në konflikt janë përfshirë 3 persona dhe shkak ka qenë një vend parkimi. Policia arrestoi dje shtetasin Ardit Isufaj, i njohur si "Doraci", 28 vjeç dhe shpalli në kërkim F.Gremi, i njohur si "Lori", 36 vjeç. Gjithashtu, është proceduar M. P., 68 vjeç. M.P ka parkuar automjetin në afërsi të shkallës së pallatit ku banon Gremi, ky i fundit është afëruar dhe ka filluar të debatohet me të. Më pas është afëruar edhe Isufaj, i cili bashkë me Gremin kanë kanosur M.P dhe kanë qëlluar me armë zjarri në ajër.



JOB ADVERTISEMENT

European Bank for Reconstruction and Development
Tirana Resident Office

The EBRD seeks to recruit a Receptionist to be based in the Tirana Resident Office

The Receptionist is responsible for providing secretarial, clerical and administrative support to Resident Office (RO) staff in order to ensure an effective and efficient operation of the office. Acting as the first point of contact the Receptionist deals with general enquiries, answers phone calls and greets visitors as they arrive at the office. They also ensure that the office activities are running smoothly in terms of supplies and equipment and support the Resident Office staff with basic clerical duties and tasks.

Accountabilities & Responsibilities

RECEPTION

- Screening incoming telephone calls (internal and external), determine purpose of calls, and forward calls to appropriate personnel or department, take and deliver messages when appropriate personnel are unavailable;
- Answer questions about organization and provide callers with address, directions, and other information;
- Deal with general inquiries in a professional and courteous manner, in person, on the telephone or via e-mail; direct inquiries as appropriate;
- Greet and receive visitors, determine nature of business, direct and accompany visitors to appropriate personnel, keep visitors log;
- Assist visiting missions.

CLERICAL/ADMINISTRATIVE

- Arrange couriers, screen, sort and process mail for RO staff;
- Scan, copy and send documents;
- Assist with maintaining the archives and filing;
- Schedule appointments for RO staff;
- Organize conference and meeting room bookings;
- Organize travel arrangements for the EBRD visitors on request;
- Provide assistance and secretarial back up to support bankers;
- Provide ad hoc support to the Office Manager;
- Responsible for the maintaining of staff whereabouts schedule;
- Responsible for checking general RO e-mail and forwarding to the relevant staff member for further action.

KNOWLEDGE, SKILLS, EXPERIENCE & QUALIFICATIONS

- Minimum secondary education, university preferred;
- Previous experience in a receptionist / secretarial capacity, preferably in international organisations;
- Excellent verbal communication skills with a good telephone manner;
- Good interpersonal skills;
- Computer literate, with keyboard skills and experience of word-processing, (Microsoft Word) and e-mail (Microsoft Outlook) combined with ability to acquire other skills as necessary;
- Ability to work on own initiative and take responsibility where necessary and to work as part of a team;
- Multilingual – excellent written and spoken English plus relevant country of operation language;
- Excellent organisational skills with ability to deal with people effectively.

Closing date: 29/10/2017

To apply for this position, please go to <https://jobs.ebrd.com/> requisition reference: 8261

Shkatërrohet rrjeti ndërkombëtar i trafikut të emigrantëve

Me bashkëpunimin e Mforcave policore të Greqisë, Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi është realizuar me sukses orët e fundit një operacion për shkatërrimin e rrjetit kriminal, që trafikonte emigrantë nëpërmjet Adriatikut drejt Italisë. Në rrjetin në fjalë, një rol të rëndësishëm kishin ish-kontrabandistë cigaresh nga Shqipëria, të cilët bashkëpunonin me keqpërsë grekë italianë dhe malazezë. Trafikantët shqiptarë gjenin skafe të shpejta për transportin, kurse grekët dhe italianët kishin marrë përsipër trafikimin e emigrantëve. Hetimet për asgjësimin e këtij grupi kanë nisur nga organet greke të rendit dhe ato italiane, ndërsa më pas kanë dhënë ndihmën e tyre edhe specialistë të policisë kundër krimit nga Shqipëria dhe Mali i Zi, raportoi "Top Channel". Pasi janë mbledhur gjithë të dhënat, janë gjetur fakte se ky rrjet ka kryer trafikime të panumërta emigrantësh, kryesisht nga Siria, Somalia dhe Iraku, duke i sjellë ata nga Turqia drejt Italisë, nëpërmjet Greqisë. Sipas dëshmitave në hetime, rrjeti kërkonte 4500 euro për çdo emigrant që do të shkonte në Brindizi ose Salento në



jug të Italisë. Shtetasit shqiptarë që ishin drejtuesit e skafave merrnin për çdo rrugë rreth 10.000 euro fitim dhe më pas shinin skaftë tek kompani të ndryshme apo persona privatë. Deri tani, nga 26 persona të përfshirë në këtë rrjet janë arrestuar vetëm 6 italianë dhe një grek, ndërsa janë dhënë mandat arreste nga policitë e tri shteteve si dhe nga EUROPOL-i për të gjithë anëtarët e tjerë.

Studio Perbarimore "SHKRELA" do të zhvillojë Ankandin e dyte për pasuritë:

- a) "Apartament", me sipërfaqe totale 77.36 m², me nr. Pasurie 6/121+1-2, e ndodhur në zonen kadastrale Nr. 8534, Volumes 5, Faqe 138, e ndodhur ne Lagjia 16 Prilli, Fier, ne pronesi te Vasiljaq Tefi Zhaka. Cnimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 16,028.88 (gjashtembdhjetë mijë e njezeto e tete pike tetedhjetë e tete) Euro.
 - b) "Apartament", me sipërfaqe totale 62.2 m², me nr. Pasurie 6/121+1-4, e ndodhur ne zonen kadastrale Nr. 8534, Volumes 5, Faqe 140, e ndodhur ne Lagjia 16 Prilli, Fier, ne pronesi te Vasiljaq Tefi Zhaka dhe Lefteri Vangjel Zhaka. Cnimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 15,332.8 (pesembdhjetë mijë e treind e tridhjetë e dy pike tete) Euro.
 - c) "Apartament", me sipërfaqe totale 74 m², me nr. Pasurie 6/36+1-4, e ndodhur ne zonen kadastrale Nr. 8534, Volumes 6, Faqe 148, e ndodhur ne Lagjia 16 Prilli, Fier, ne bashkepronesi te Vasiljaq Tefi Zhaka dhe Lefteri Vangjel Zhaka. Cnimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 13,440 (trembdhjetë mijë e katërqind e dyzete) Euro.
 - d) "Apartament", me sipërfaqe totale 51 m², me nr. Pasurie 116/71+1-31, e ndodhur ne zonen kadastrale Nr. 2291, Volumes 29, Faqe 174, e ndodhur ne Kryemedheri, Kavaje, ne pronesi te Vasiljaq Tefi Zhaka. Cnimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 13,440 (trembdhjetë mijë e katërqind e dyzete) Euro.
- Pasuritë jane ne bashkepronesi te Vasiljaq Zhaka dhe Lefteri Zhaka dhe te hipotekuara ne favor te banks. Ankandi i dyte zhvillohet me date 26.10.2017, ora 16.00 ne ambientet e Studios Perbarimore Shkrele me Adrese:Rruga Blv. "Zogu i I", Pall. "Agimi", H 2, K 3, Ap. 5, Tirane.

Policia në kërkim të autorëve, dyshime se ka lidhje me detyrën

Kërcënohet avokatja në Tiranë, gjen letër dhe një kallëp tritoli në makinë

Alma Zyba: Nuk kam konflikte me njeri

Xhensila Kodra

Një avokate 42-vjeçare nga Tirana është kërcënuar nga persona ende të paidentifikuar, duke i vendosur tritoli në makinë së bashku me një letër kërcënuese. Ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë në rrugën "Panorama", në kryeqytet. Burime të besuara nga policia bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se bëhet fjalë për avokaten Alma Zyba. Kjo e fundit, sapo ka konstatuar lëndën plasëse, ka lajmëruar menjëherë uniformat blu. Këta të fundit të mbërritur në vendin e ngjarjes nisën menjëherë hetimin për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të kësaj ngjarjeje. Avokatja ka pohuar se nuk ka konflikte me ndonjë person, ndër-



sa ngjarjen e rëndë e lidh me detyrën që ajo kryen.

KALLËZIMI

Kallëzimi në komisaratin numër 1 të policisë është bërë nga vetë avokatja Alma Zyba, banuese në Tiranë. Kjo e fundit u ka treguar uniformave blu se e kishte gjetur xhamin e mjetit të saj tip "Volkswagen" të thyer brenda.

Fillimisht 42-vjeçarja kishte menduar se mund të bëhej fjalë për një vjedhje, por më pas kishte parë se brenda mjetit i ishte vendosur një letër me shkrim kërcënues, si dhe një kallëp i dyshuar lëndë eksplozive. 42-vjeçarja ka mohuar të ketë probleme me njeri. Ndërkaq, burimet e lartpërmendura sqaruan se policia

NJOFTIMI I POLICISË

"Më datë 19.10.2017, në rrugën "Panorama", shtetases A.Z., 42 vjeçe, banuese në Tiranë, i kanë thyer xhamin e mjetit tip "Volkswagen", ku brenda në mjet u gjet dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale, një letër me shkrim kërcënues dhe një kallëp i dyshuar lëndë eksplozive. Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorit. Nenet 84 e 278/5 të Kodit Penal".

dyshon se kërcënimin mund të jetë bërë për shkak të punës që ajo kryen. Aktualisht, blutë e kryeqytetit janë duke punuar për identifikimin dhe vënien në pranga të autorit të kësaj ngjarjeje. Për këtë, grupi hetimor ka sekuestruar edhe pamjet e disa kamerave të sigurisë përgjatë zonës ku mjeti ishte i parkuar.



Sekuestrohet gomonia me 1.5 tonë kanabis, arrestohen dy shqiptarë

ITALI. Policia italiane ka shkatërruar një tjetër rast të trafikut të drogës nga Shqipëria drejt Italisë. Sipas mediave të huaja, mësohet se autoritetet kanë bllokuar një gomone me 1.5 tonë kanabis sativa, si dhe kanë vënë në pranga dy skafistët shqiptarë. Sipas tyre, dy personat e arrestuar janë shtetasit me inicialet V.L. 31 vjeç dhe T.N. 26 vjeç. Mësohet se gomonia ishte 10 metra e gjatë dhe kishte dy motorë të fuqishëm. Hetuesit italianë thonë se lëndë narkotike ishte e ndarë 64 pako. Sipas tyre, nëse droga do të shitej me pakicë, do të kapte një vlerë prej 15 milionë euro. Dy skafistët shqiptarë, identiteti i të cilëve nuk është bërë me dije për shkak të hetimeve, tentuan të arratiseshin në det të hapur dhe situatën shpejtësinë e gomones kur panë se po ndiqeshin nga Guardia di Finanza. Por, tentativa e tyre për t'u arratisur dështoi dhe u dorëzuan. Sipas mediave italiane, për goditjen e këtij rasti të trafikut të drogës pati bashkëpunim mes autoriteteve italiane dhe policisë shqiptare në Durrës. Ndërkaq, pak ditë më parë po në Itali u kapën në zonën e Ferraras 2 tonë kanabis, që po transportohej me 2 furgonë dhe u arrestua një 19-vjeçar nga Vlora. Sipas hetuesve të huaj, u raportua se kjo sasi droge dyshohej se ishte nisur nga brigjet shqiptare. Mësohet se i riu shqiptar që përfundoi në pranga ishte shtetasi Ronaldo Rapi, ndërsa sasia e drogës nëse do hidhej në treg, do të kapte vlerën e më shumë se 20 milionë eurove. Sipas mediave italiane, u raportua se që nga muaji janar i këtij viti deri më tani janë konfiskuar mbi 30 tonë marijuana, janë arrestuar rreth 50 persona, si dhe janë sekuestruar të paktën 24 sakafe e gomone që përdoren nga bandat kriminale për trafikun e drogës.



Implemented by giz

Programme: Customer and Performance Oriented Drinking Water and Sanitation Services

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The water programme CPWS assists Albania to provide affordable water supply and sewerage services to its population with an orientation at EU standards. In particular support is planned to the following four areas:

1. implementation and further development of the water sector re-structuring
2. efficient and sustainable services by water and sewerage utilities
3. effective water sector regulation
4. increased performance orientation, accountability and involvement of consumers

At local level the programme supports three partner municipalities and their water utilities in the improvement of drinking water and sanitation services, especially performance orientation, accountability and in customer orientation. For the support of the GIZ expert team, GIZ Office Albania is looking for a

Advisor hydro-engineer

with focus on water supply and sanitation.

A. Responsibilities

Assistance to the GIZ expert team particularly but not only on the local level for the municipalities and their water utilities to improve drinking water supply and sanitation services. Assistance to advisory services shall be rendered on technical development of water services in a participatory manner with water utility staff:

- To advise the water utilities on appropriate implementation of the water utilities; service mandate (urban/rural) to improve the company's core processes, like production, delivery, energy efficiency, O&M, effluent quality control
- Advice on implementing water safety plans
- Advice on health and safety plans for water utility staff
- Assistance in training (on-the-job)
- Advice on improvement of data quality
- Advice on sampling and quick analysis of drinking water and effluents

B. Tasks

The Hydro-engineer performs the following tasks:

- Participating in identifying needs for external support and advice for the water utilities
- Follow-up of project progress and activities in close cooperation with the partners
- Contributing to the preparation of technical reports and to the annual reports for the programme manager
- Assists in the preparation of terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties in carrying out project/programme's activities, including performance evaluation and impact monitoring
- Assistance in preparation and implementation of workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the programme's/project's field of activities
- Advises the AV on acquisition potential and modes for closer collaboration among development partners

Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts and dialogues with project partners, as well as with other projects in Albania in order to enhance and maintain good working relationships
- Communicates and channels local interests and exchanges ideas and information for the benefit of the programme
- Maintains repeated field visits to the project intervention area in accordance with the requirements of the project

Knowledge management

- Assist in improving the programme's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Prepares reports and presentation materials
- Prepares appropriate input to the various project/programme reports/publications including annual reports; contributes to other reports required by the Programme Manager and GIZ Headquarters.

Management and Coordination tasks

- Assists the programme team in the general project planning
 - Assists in the coordination and prioritisation of relevant project activities in cooperation with the partners, as well as in organizational preparation and implementation of these activities
- Required qualifications, competences and experience:
- Masters/bachelor degree in civil engineering (Hydro technical engineering) or related fields or extended professional working experience
 - At least 2 years of work experience in a relevant area
 - Ability to support a multi-task, multi-discipline programme team
 - Fluency in written and spoken English, German language would be an asset
 - Able to work in a team as well as independently
 - Excellent social and communications skills

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Frequent travelling within Albania (particularly to the three partner municipalities Cerrik, Peqin and Himara)
- Assignment period 01/2018 -09/2019

Please forward your application until 31st of October, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Problemet me faqen, si mund të regjistroheni për të përfituar

Lotaria Amerikane, ambasada: Rifilloni aplikimin, s'ju quhet

"Nuk duhet të bëni më shumë se një kërkesë për DV-2019"

Ornela Manjani

Nëse jeni regjistruar përpara të mërkurës, datë 18 tetor 2017, për Lotarinë Amerikane, ky regjistrim nuk do të jetë i vlefshëm. Ju duhet të bëni një regjistrim të ri gjatë periudhës së re të dhënë nga ambasada e SHBA-ve në Tiranë. Individët, të cilët bëjnë më shumë se një regjistrim gjatë periudhës së re të regjistrimit do të skualifikohen. Specialistët në ambasadë sqarojnë se për shkak të problemeve teknike, periudha e regjistrimit për Lotarinë DV-2019 do të rifillojë nga e para. Të gjitha regjistrimet e bëra përpara datës 18 tetor 2017 do të duhet të ribëhen për t'u marrë në konsideratë. "Na vjen keq për shqetësimin e



krijuar për aplikantët e vizave të shumëllojshmërisë. Për të siguruar drejtësi dhe për të mbrojtur integritetin e procesit për të gjithë ata që janë të interesuar, ne duhet ta rifillojmë procesin e regjistrimit për këtë vit (DV-2019). Periudha e re e regjistrimit për Lotarinë DV-2019 do të hapet të mërkurën, 18 tetor 2017, në orën 18:00

ora lokale e Shqipërisë dhe mbyllet më 22 nëntor 2017, ora 17:00 ora lokale e Shqipërisë", thotë njoftimi i ambasadës amerikane. Aplikantët mund të regjistrohen elektronikisht në faqen zyrtare të E-DV, state.gov, gjatë periudhës së re të regjistrimit. Udhëzimet e DV, gjithashtu, janë në dispozicion në faqen e internetit të Departamentit të Shtetit në

usvisas.state.gov/dv/instructions ose në faqen e ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë <https://al.usembassy.gov/sq/visas-sq/immigrant-visas-sq/diversity-visa-sq/>. Duke filluar nga 15 maji 2018, për të parë nëse janë përgjedorur, të regjistruarit e DV-2019 do të mund të përdorin numrin e tyre unik të konfirmimit të dhënë në regjistrim duke kontrolluar online Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve në state.gov. Kontrolli i Statusit të Regjistruarve do të informojë pjesëmarrësit e përgjedorur se si të aplikojnë për vizën e Lotarisë për veten dhe anëtarët e tyre të familjes. Departamenti, gjithashtu, do t'u konfirmojë të përgjedorurve datat e tyre të intervistave për vizë nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve.

KLSH: Ujësjelesi i Tiranës abuzoi me mbi 2.6 mln fatura

Drejtoria e Ujësjeles Kanalizimeve Tiranë ka lëshuar 2.6 milionë fatura në shkelje të ligjit. Bëhet fjalë për fatura të gjeneruara nga sistemi UKT-së me numra seriale, që nuk janë certifikuar nga administrata tatimore, ashtu sikurse kërkohet nga kuadri ligjor. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar këtë mangësi gjatë një auditimi të zhvilluar pranë UKT-së, ku ka rezultuar se faturat e vitit 2016 të gjeneruara nga sistemi "Al Billing" kishin numra seriale, që nuk ishin autorizuar sipas procedurës nga ana e Tatimeve. Në këto fatura nga ana e ujësjelesit janë mbledhur edhe taksa të tjera, për të cilat ky subjekt është zgjedhur si agjent tatimor. Gjetjet e kontrollit të rregullshmërisë,



Kontrolli i Lartë i Shtetit lidhur me sistemin "Al Billing" i ka përmbledhur në tre pika. "1. UKT nëpërmjet aplikacionit 'Billing' me numrave seriale të pacertifikuar nga Autoriteti Tatimor, në kundërshtim me ligjet tatimore. Në këto fatura është aplikuar edhe mbajtja e taksave të tjera, të cilat UKT mbledh. 2. UKT nuk ka bërë kërkesën pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj për miratimin dhe tërheqjen e diapazonit të numrave seriale. 3. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, e cila është venë në dëgjim për miratimin e kësaj fature kompjuterike tatimore me shkresën nr. 6613/1, datë 07.03.2016 nuk rezultoi të ketë kryer asnjë kontroll për të detyruar UKT-në të zbatojë ligjet tatimore. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 38-39 të raportit të auditimit)", thuhet në njoftimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Pas kësaj, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar që UKT të bëjë kërkesë pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj për miratimin e diapazonit të numrave seriale, gjenierimit të faturave tatimore kompjuterike të shitjes nga UKT vetëm me numrat e miratuar nga organet tatimore.



MACEDONIA
Agency for Promotion and Support
of Tourism
www.macedonia-timeless.com

Shopping në Shkup





Me ofertën e saj të pasur, Shkupi është bërë pjesë e hartës botërore të destinacioneve atraktive turistike në rajon. Qyteti i Shkupit me krenari mund t'u ofrojë vizitorëve një numër të madh përmbajtjesh me karakter kulturor dhe argëtues, sepse është një përzjerje e veçantë e bukurive qytetërore, kulturore, natyrore dhe rariteteve. Shkupi është një metropol, zemra urbane e të cilit troket 24/7 dhe çdo vizitor mund të kënaqet dhe të relaksohet në shume përmbajtje argëtuese që do ta bëjnë qëndrimin e tij në Shkup më interesant dhe më të paharrueshëm. Nëse pyetni një Shkupjan se ku mund të ndihet fryma e kryeqytetit, ai me siguri do të të drejtojë për një shëtitje në çarshinë e Vjetër të Shkupit, çarshija përshkruan shoqërinë multikulturore të qytetit. Qyteti ju fton për të vizituar qendrat tregtare moderne dhe të jeni në trend me markat e fundit.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 581

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE Redaktore: Enida Himaj - Art Designer: Nevila Samarzhi

E shtunë 21 Tetor 2017

KRISTIN PRENGAJ, SHTATZENE

JA FEJESA INTIME ME PARTNERIN BIZNESMEN



Jeta e re në Greqi e seks-simbolit shqiptar



KLAUDIA KALIA:

JU RREFEJ SKANDALET QE NDODHIN NEPER KOMPETICIONET E BUKURISE



"PORTOKALLIA"

TE GJITHE TE LARGUARIT, KONFLIKTET QE PATEN



Inis Gjoni rrëfen sesi ia ka shpjeguar vajzës mungesën e babait

"I kam thënë vetëm të vërtetën"

Regjisoria e njohur Inis Gjoni ka qenë e ftuar në emisionin "Wake up", ku ka folur kryesisht për premierën e saj të re, "Çifti i çuditshëm". Inisi ka treguar gjithashtu sesi e menaxhon kohën në punë dhe kohën me vajzën e saj, Coco Antonel. Ish-prezantuesja në fakt është edhe nënë, edhe baba për vajzën e saj, pasi fatkeqësisht bashkeshorti i saj është ndarë nga jeta në vitin 2011. E pyetur sesi ia shpjegon ajo vajzës mungesën e të atit, Inisi ka treguar se ka zgjedhur t'i tregojë të vërtetën të bijës. "Sigurisht që figura e babait është një shtyllë e rëndësishme në jetën e gjithkujt, por ajo nuk e ka njohur. Megjithatë, unë ia kam shpjeguar shumë thjesht, duke i thënë se jeta është e tillë. Disa e kanë lart në qiell, disa janë të ndarë e disa të tjerë janë, por më mirë të mos ishin sepse s'kanë asnjë lloj përgjegjësie", – është shprehur regjisoria.



Fejohet Seldi dhe Mimoza Shkodra, ja detajet e festës së sotme

Deri pak kohë më parë lidhja e tyre mbetej mister, pasi vetë këngëtarët dolën dhe e përgëneshtruan këtë lajm. Por, duket se të dy nuk mundën ta mbajnë të fshehtë për shumë kohë, duke deklaruar dashurinë mes tyre. Seldi Qalliu dhe Mimoza Shkodra pak javë më parë konfirmuan se janë në lidhje së bashku. Por, dyshja kanë bërë edhe një hap më tej. Seldi e Mimoza kanë vendosur që dashurinë ta zyrtarizojnë me fejesë. Bëhet me dije se ceremonia u mbajt mbrëmjen e djeshme në Zvicër dhe me aq sa kemi mundur të mësojmë, ka qenë një festë intime vetëm me familjarët dhe miqtë e afërt të çiftit.



Festa erotike e Encës

Puthje lesbike dhe 'twerk' për ditëlindjen e këngëtares Deri më tani ishin publikuar pamjet e një feste modeste nga ditëlindja e këngëtares Enca Haxhiu. U duk e çuditshme kaq qetësi për një festë të organizuar nga ajo. Lule, torta dhe tullumbace, dukej gjithçka larg natyrës së Encës. Së fundmi në rrjetet e saj sociale janë publikuar momente nga festimet. Ajo është parë mjaft provokuese e veshur me një fustan seksi të bardhë, i cili ve në pah format e saj trupore mjaft bombastike. Miq të shumtë ishin në festën e saj, ku duket qartë se është bërë qejf i shfrenuar. Nuk mund të mungonte një 'twerk' i fuqishëm nga Enca. Ngacmuese ishte edhe një puthje e dhënë kalimthi në buzë për mikeshën e saj. Krahas festimeve, Enca ka marrë edhe dhurata që s'kanë të mbaruar.



Jeta e re në Greqi e seks-simbolit shqiptar

KRISTIN PRENGAJ, SHTATZËNË

Ja fejesa intime me partnerin biznesmen



Bukuroshja e ekranit ia doli që në pak kohë të shndërrohej në kryefjalën e mediave. Foto seksi, lidhje të përfolura, pushime luksoze ishin shpesh lajmet që na vinin prej saj. Flasin për Kristin Prengajn, e cila prej kohësh u mungon rrjeteve sociale, por edhe publikut. Ashtu siç "Summer Pages" raportoi gjatë verës, modelja po shijonte dashurinë në krahët e partnerit biznesmen. Siç kemi bërë me dije, modelja po bashkëjeton me të dashurin e saj në Athinë, ku djaloshi fatlum ka disa bi-

znese. Por, duket se një tjetër lajm edhe më i gëzueshëm na vjen nga biondja seksi. "Bluetooth" ka mundur të mësojë se Kristin është në muajt e parë të shtatzënisë. Kështu, modelja e suksesshme dhe partneri saj janë në pritje të fëmijës së tyre të parë. Burime pranë bukuroshes kanë thënë se çifti ka bërë edhe një festë fejese të vogël në Greqi, duke pasur pranë vetëm familjarët e tyre të afërt. Duket se vajza që provokonte në çdo dalje të saj ka hequr dorë përfundimisht nga jeta publike, duke u shndërruar në një familjare të rregullt, madje për pak muaj edhe në një



nënë të re. Kujtojmë se lidhja e Kristin, me djalin misterioz, që kurrë nuk ia ka publikuar fytyrën, u bë publike në fillim të këtij viti. Udhëtimet e bukuroshes drejt Greqisë u shtuan edhe për shkak të fejuarit të saj, i cili ka disa komplekse turistike në Greqi. Prej disa muajsh kjo bukuroshe ka mbyllur edhe llogarinë në "Instagram", ku kishte me mijëra ndjekës, duke iu përkushtuar tashmë historisë së dashurisë. Nga atë sa kemi mundur të mësojmë, çifti ka më shumë se një vit bashkë dhe janë më të dashuruar se kurrë. Duket se ka qenë partneri, ai që i ka kërkuar Kristit të heqë dorë nga karriera, për të qëndruar për pak kohë bashkë jashtë Shqipërisë. Natyrisht që shpeshherë biondja seksi vjen në Tiranë për të vizituar familjen e saj, por vizitat këtë herë janë disaditore, për t'u rikthyer shpejt tek i fejuari. Edhe pse ishte në kulmin e suksesit, Kristin Prengaj zgjodhi të heqë dorë për hir të të dashurit xheloz, duke shpëtuar kështu dashurinë e saj.



RRËFEHET MODELJA: KUR MË PENALIZON BUKURIA

KLAUDIA KALIA:

Ju rrëfej skandalet që ndodhin nëpër kompeticionet e bukurisë



“Dashuria për mua është vetëm familja ime”

Pamela Aliaj

Klaudia Kalia është bukuroshja, e cila fitoi këtë vit kurorën e Miss Grand International 2017, por ajo që pikasi më tepër ishte një status i saj i postuar para pak ditësh ku thuhet se pjesëmarrja e miseve jashtë vendit nuk investohej më nga produktioni vetë, por duhet të ishin vetë fitueset ato që nga xhepi i tyre të udhëtonin e të mbulonin gjithë shpenzimet. Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Klaudia ka treguar prapaskenat që jo vetëm ajo, por pothuajse çdo fituese misi duhet të kalojë për të marrë pjesë jashtë vendit me konkurrentet e tjera. Gjithashtu, Klaudia ka folur edhe për aspiratat e saj për të ardhmen, si një 18-vjeçare, dëshirat që ajo ka dhe ku e

shih veten pas këtij kompeticioni.

Je shpallur Miss Grand International 2017. Si është të jesh më e bukura shqiptare?

Është një ndjesi e bukur, por është dhe përgjegjësi, sepse mban mbi vete një titull.

Sa kujdeset për veten Klaudia për të qenë në top formë?

Të them të drejtën nuk është se i kam fituar këto forma nga palestra, por është veçse një dhuratë nga nëna natyrë, më pëlqejnë ecjet e gjata dhe nuk jam mësuar të rri në një vend.

Në statusin tuaj të fundit kishit shkruar se produktioni nuk ju financoi për të marrë pjesë në “Miss Grand International”. Pse ndodhi një gjë e tillë? A ndërhytë në mënyra të tjera për të qenë pjesë e këtij eventi?

Po është e vërtetë. Nuk e





kuptoj pse ne që fitojmë duhet të paguajmë edhe faturën për të shkuar atje kur ndërkohë produksioni merr sponsorizime për këtë event dhe duhet t'i përdori për këto raste. Ndaj dhe nuk më pëlqeu kjo sjellje. E di që shumica e miseve në Shqipëri e pranojnë vetëm për të shkuar në këto kompeticione duke paguar jo vetëm çmimin, por edhe shpenzimet e tjera, por nuk është rasti im. Është turp që vetëm në Shqipëri ndodhin gjëra të tilla. Kam kontaktuar edhe me disa vajza që përfaqësojnë vendet e tjera dhe një gjë e tillë i është dukur të thuash pak skandaloze. Jo vetëm që produksioni merr përsipër shpenzimet, veshjet, akomodimin, por i mundëson edhe një shoqërues.

Çfarë projektesh të reja e presin Klaudian tani që mban një titull të tillë?

Nëse do tregohesha e sinqertë sigurisht që titulli që mbaj më ka lehtësuar në këtë fushë, por produksionet shohin edhe përtej misit, çka do të thotë që shohin personazhin dhe sa është i aftë të aktojë, modelojë ose pozojë. Projekti i radhës është jashtë Shqipërisë, por për momentin jam akoma në bisedime.


Sa e vështirë është të jesh në qendër të vëmendjes? Cila është pjesa që të bezdis më tepër?

Sigurisht që, edhe nëse nuk më njohin kur shfaqem diku, nuk shpëtoj pa u parë apo komentuar nga personat, që mund të ndodhen aty, por kjo për mua nuk përbën ndonjë ndryshim. Ndoshta gjatësia, format apo kaçurrelat e mia më bëjnë të dukem më shumë se disa të tjera. Është e bukur të tërheqësh vëmendjen, por normalisht edhe kjo anë është edhe pozitive, edhe negative. Shpesh herë bezdia krijohet, në fakt, nga


njerëz që kontaktojnë dhe shfaqen si producentë, agjenci modelingu, njerëz të angazhuar me tv kur ndërkohë s'kanë asnjë lidhje, por thjesht duan të të takojnë.

A keni pasur oferta pas fitores? Çfarë konkretisht?

Sigurisht ofertat nuk kanë munguar, por nuk kanë qenë



ato që unë realisht kam dashur për veten. Përtej faktit që jam kontaktuar nga një person që mendoj po më ndihmon shumë në këtë rrugëtim, ku deri tani kam bërë shumë gjëra në këtë fushë (reklama, sfilata, foto) më ka ndaluar në rrugë dhe më propozoi të jem pjesë e modeleve që ai menaxhon dhe pranova pasi kisha dëgjuar për të. Më e bukur ishte që as nuk dinte që isha miss. aktualisht jam pjesë e "sonny's angels".



Do të dëshironit të vazhdonit rrugën e modelingut dhe fotografisë si shumë mise të tjera apo keni të tjera projekte për të ardhmen tuaj?

Për sa kohë do kem mundësi ta bëj do vazhdoj. Normalisht, duke qenë se modelingu nuk është kaq i zhvilluar, prioritet kam shkollimin dhe këto kohë po mendoj degen që do zgjedh në universitet. Modelingu për mua është pasion, por nuk e shoh si gjënë më të rëndësishme për veten.

Shumë femra të bukura ankohen se njerëzit nuk i marrin seriozisht dhe shohin vetëm pamjen e jashtme, pa i njohur mirë. Sa e "penalizon" pamja e jashtme Klaudian?

Kjo me penalizon vetëm, sepse njerëzit tërhiqen shumë nga pamja apo gjatësia ime, ndoshta dukem e paarritshme kur ndërkohë mendoj që jam një vajzë e thjeshtë si gjithë moshataret e mia. E jetoj jetën si një 18-vjeçare normale, as si 15, as si 25.

Keni realizuar një fotosesion shumë seksi. A keni pasur propozime nga fotografë të njohur? Ku do ta shohim Klaudian në të ardhmen?

Propozime thujse kam

përditë, por përpiqem edhe të vlerësoj çfarë është më e mirë për mua, nëse ja vlen ose jo dhe për këtë këshillohem gjithmonë. E ardhmja ime? Mendoj gazetarinë, në fakt, por akoma jam në zgjedhje e sipër.

Për sa i përket dashurisë, a është dikush i rëndësishëm në jetën tuaj?

Për momentin dashuria ime është familja ime. Për një lidhje mendoj që kam kohë. Prioritet kam shkollimin dhe realizimin e vetes sime. Ndoshta duket pak egoiste si gjë, por, nëse personat limitojnë veten me një lidhje duke harruar prioritetet e moshës, shpeshherë nuk arrijnë aty ku duan.



Pamela Aliaj

Të gjithë të larguarit nga "Portokallia". Konfliktet që patën

Nga Agron Llakaj, tek Ermal Mamaqi, ja pse ikën nga puna

Shumë shqiptarë brenda dhe jashtë vendit sa herë që vjen e diela, prej shumë vitesh tashmë janë mësuar dhe mezi presin të shohin një nga 'show'-t humoristik më të famshëm në vend, "Portokalli". Një kast aktorësh të shumtë dhe vërtetë të talentuar, kanë bërë që ky 'show' të jetë i suksesshëm për shumë vite radhazi. Por, për një arsye apo për një tjetër, shumë prej aktorëve nisën të largoheshin, duke mos qenë më pjesë spektaklit të humorit dhe shumë personazhe që ata përfaqësonin "u harruan" me kalimin e kohës. Nuk është hera e parë që dëgjohet se shkak i largimit të tyre ishte një konflikt i brendshëm me drejtorin e këtij formati, Altin Bashën. Shumë prej tyre nuk kanë dhënë një arsye të qartë për largimin, por ka qenë vetë djali i humoristit të njohur Zef Deda, Juli, i cili para pak kohësh postoi në faqen e tij një status për largimin e tij dhe kolegëve të tij ndër vite duke thënë edhe shkakun kryesor të këtyre largimeve, pas shumë kohësh thashethemesh. Por, nuk mungoi as reagimi i një tjetër aktori të kësaj trupe, i cili edhe pse më i ri se Juli në këtë 'show', nuk harroi të falënderonte drejtorin në një status të postuar në faqen e tij. Pra, kjo na lë të mendojmë se nuk janë të gjithë të një mendimi me Bashën, por kjo s'do të thotë se arsyet e "fishjes" së këtyre personazheve nga "Portokalli" e bëri atë të zbehet edhe më tepër. Mbase për këtë qëndron arsyeja e të tjerë personazheve që janë ende pjesë e saj prej shumë vitesh tashmë. Edhe pse para se do të niste sezoni i ri dëgjua se do të largohej edhe "Polic" i "Portokallisë", edhe Gaz Paja nuk u shfaq në serinë e kaluar. Nuk dihet ende se ç'po ndodh me kastin e këtij formati humoristik, por një gjë është e sigurt, largimi i figurave të citat e kanë "ngritur" "Portokallinë" do të çonte vërtet në uljen e shikueshmërisë të këtij formati, edhe pse duhet ta pranojmë, tashmë nuk është siç ka qenë më parë. Më poshtë po listojmë personazhet që i dhanë jetë "Portokallisë" me rolet e tyre:

Ervina Kotolloshi - Shajponja Dhëmbi
Ajo ishte një nga personazhet më të lezetshme dhe më unike të këtij formati. Personazhi i saj u pëllye shumë që kur u shfaq në fillim. Nën rolin e një gazetareje nga fshatrat e Korçës, ajo ishte kudo e pranishme në daljet e politikanëve, ku batutat më të shumta ishin me personazhin e kryeministrit të tanishëm, Edi Rama; kryetarit të Bashkisë së Tiranës në atë kohë. Gjithnjë prijte me duartrokite dhe me shumë të qeshura. Arsyeya e largimit të saj thuhet se ishte Anglia, pra një mundësi më e mirë jashtë vendit.

Agron Llakaj
Ai është një nga aktorët më të njohur



hur në gjithë vendin dhe jashtë tij. Një ndër humoristët që ka bërë të qeshin breza të tërë shqiptarësh. Ai erdhi me "lindjen" e këtij spektakli humoristik. Kur ishte nën drejtimin e tij, jo vetëm që audienca u rrit më së shumti, por gjithashtu edhe të qeshurat s'kishin fund me personazhet e shumëllajshme që sillte, duke veqar këtu rolin e papërsëritshëm të ish-kryeministrit të vendit, Sali Berisha. Arsyeya e largimit të tij thuhet se ishte konflikti me drejtorin Altin Basha. Llakaj sot, prej disa vitesh është drejtuesi dhe ideatori i 'show'-t "Al-Pazar", formati konkurrant humoristik, i cili transmetohet në "Vizion Plus".

Julian Deda
Siç thamë edhe më sipër, ky ishte pikërisht aktori i "Portokallisë", i cili vendosi të fiasë pas një heshitje të gjatë e largimesh të pashpjeguara. Jul Deda, djali i humoristit të njohur shkodoran, Zef Deda, spikati me talentin e tij në këtë 'show' me grupin e njohur "The SHBLSH", të cilët sollën situata humoristike pafund, duke e bërë publikun të qeshë me lot dhe ta dojë së tepërmi. Juli ishte ai që nëpërmjet një statusi tha se arsyeja kryesore e largimit të kolegëve të tij ishte pikërisht konflikti me drejtorin e spektaklit, Altin Basha. Aktualisht ai është pjesë e një formati humoristik në "Vizion Plus", "Apartamenti 2XL", i cili sjell situata të stisura humoristike nga

aktorët dhe të ftuarit e radhës.

Ermal Mamaqi
Ai gjithashtu ishte pjesë e grupit të njohur "The SHBLSH" dhe iku në të njëjtën kohë me Julin dhe Gent Zenelaj. Aktualisht Ermali drejton 'show'-n e tij, "Xing me Ermalin", ku sjell nëpërmjet të ftuarit të radhës, situata pafund të qeshurash dhe argëtimi.

Gentian Zenelaj
I treti i muskëtierëve të "The SHBLSH". Genti së bashku me dy shokët e tjerë ishte i pandarë edhe pas largimit nga "Portokalli". Juli në kohën kur u larguan tha se arsyeja kryesore ishte një konflikt i tij dhe Gentit me Altin Bashën, që i bëri të tre të largohen. "Ka qenë një mosmarrëveshje mes meje, Gentit dhe regjisorit të 'Portokallisë', shokut regjisor, i cili pavarësisht se punon në vitin 2008, mendja i ka mbetur në vitin 1973. Është e çuditshme se si këto ndjenja të tij superkomuniste zgjohen këto muajt e fundit", është shprehur Jul Deda për "Bluetooh" para disa vitesh. Genti u bashkua së bashku me Julin dhe Ermalin më vonë 'show'-t "Apartamenti 2XL", por më pas e "braktisi" edhe atë, ashtu siç thotë Juli, duke e "lënë në baltë" shokun pa i dhënë asnjë shpjegim. Sot ai së bashku me kolegun e tij të ri, Saimir Kodra, drejtojnë emisionin investigativ, "Stop" në TV "Klan".

Ervin Bejleri
Ai ishte një nga aktorët më të

vjetër, pjesë e trupës së parë të "Portokallisë", i cili spikati me rolin e tij të veçantë të Vinit, romit nga Tirana, i cili ishte gjithnjë në duet me Ninin, i cili luhej nga Elvis Pupa. Arsyeya e largimit të tij nuk u bë e ditur. Tanimë ai është pjesë e një emisioni të ri politiko-satirizues në "InTV", "Kolaudim". "Qëllimi i emisionit tonë në njëfarë mënyre është të 'koloaudojë' halllet dhe problemet që ka sot shoqëria shqiptare. Por, në radhë të parë duke filluar nga lart... po nga lart fare ama", ka thënë për "Vip Pages", Ervini.

Elvis Pupa
Siç thamë edhe më lartë, Pupa vinte në duet me Bejlerin në rolin e romit nga Tirana. Të dy së bashku kanë krijuar shumë atmosferë argëtuese dhe humoristike me situatat e sjella në skenë të dy romëve, të cilët e shijonin jetën në maksimum në mënyrën e tyre. Elvsi u largua përpara Ervinit nga "Portokalli", ndonëse arsyeja ishte në dukje jete-sja jashtë vendit, në SHBA, por nuk u tha ekzaktesisht arsyeja e vërtetë. Ndërkohë që sot Ervini është rikthyer dhe drejton një 'show' të tijin humoristik, "M'fal për shprehjen".

Gent Bejko
Genti është prezantuar për herë të parë me monologët e tij humoristike, për t'u bashkuar më vonë me aktorë të tjerë të "Portokallisë" në grupin e famshëm të "The SHBLSH", ku batutat të tij qeshur

ishin të pafundme. Në një intervistë të dhënë para disa vitesh, Genti thoshte se nuk ishte asgjë personale, largimi ishte thjesht biznes. Ky largim pasoi me futjen si regjisor në 'show'-n e "Vizion Plus", "Apartamenti 2XL", ku nuk qëndroi për shumë kohë. Tashmë ai jeton në Amerikë, ku i është bashkuar Hollivudit me role të vogla pranë figurave të njohura botërore.

Erand Sojli
Ai qëndroi për një kohë të gjatë në trupën e "Portokalli" duke sjellë personazhe nga më të ndryshmet, ku ndër të spikaturat ishte në rolin e Naqes me Nasi Gjymin, me aktorin që vazhdon të jetë në "Portokalli", Gaz Paja. Në një intervistë të bërë së fundmi, ai është shprehur se kishite kur për shkak të parimeve që kishite, që nuk e vlerësonin për aq kohë sa kishte aty. "Kur unë jam dikush që shkruaj, investoj dhe kam 10 vite që jap për këtë gjë, natyrisht që nuk meritoj të njëjtin trajtim me një person që vjen dhe është aty për të bërë një punë, që nuk e ka në perceptimin e tij real sesa e rëndësishme është", - tha Sojli. Aktualisht ai jeton në SHBA për të qenë pjesë e një filmi dhe ndoshta për të jetuar atje.

Romir Zalla
Ai ishte një nga aktorët që nisën "Portokallinë" me rolet e tij të shumtë dhe të pëlqyer nga publiku. Ndër të mund të përmendim rolin e psikologut, së bashku me aktorin Marin Orhanasi në rolin e pacientit, i cili vazhdon të jetë pjesë e spektaklit humoristik. Arsyeya përse ai është larguar nuk është bërë e ditur. Sot ai është pjesë e pandarë e teatrit komëtar, duke sjellë në skenë role të ndryshme dramatike e humoristike.

Besart Kallaku
Dhe largimi i fundit nga "Portokalli" është "Skifteri" i famshëm prej Laçi, i cili jo vetëm me këtë rol fantastik, por edhe me shumë të tjera, ka kënaqur publikun shqiptar ndër vite. Jo më larg se një muaj më parë ai kurorëzoi dashurinë me bukurshen Xhensila Myrteza. Shumë projekte e presin në të ardhmen Besin, i cili për momentin zotëron restorantin e njohur "Ardit's fisherman". Arsyeya e largimit të tij nuk u bë e qartë, ndërkohë që thashetheme të ndryshme qarkullojnë për largimin e tij jashtë vendit.

TRASHEGIMIA

ZBULIMET ARKEOLOGJIKE

Dalin në dritë rrënoja të shek. V dhe varreza e Neolitit

Fatmira Nikolli

Edhëna e parë ishte një topim. Zona kodrinore buzë lumit njëhijë prej banorëve si bregu i hamamit. E megjithatë, gjithë ç'shihej ishte një shpat me bimësi të madhe e shkurre, që ngjiteshin kodrinës përpjetë. Në trasenë 38-metërshe për gjurmën e TAP në Fushë Peshtan të Beratit, arkeologët së pari pikasën një strukturë muri, që e identifikuan më pas si absidën e një kishëze, matanë një varr dhe gërmimet e mëtejshme zbuluan një "miniqytezë" bashkë me "agoran" e kalldrëmtë, që në shtrirjen e saj dëshmon shekuj historie. "Duke qenë se zona ishte identifikuar si zonë me potencial të lartë arkeologjik, TAP ndërmoi një gërmim arkeologjik shpëtimi, përpara se ekipi i ndërtimit të gazsjellësit të hynte në këtë zonë", thotë për "GSH" Lorenc Bejko, një ndër arkeologët më të mirë në vend. Nga gërmimet arkeologjike doli në dritë një banesë komplekse e shtrirë në disa tarraca me disa faza të ndryshme historike. Kodrina e shkurreve nxori tanimë në dritë shtresëzime qytetërimesh, që tregonin për vijimësi jete në periudha të ndryshme. "Rrënojat më të vjetra i takonin periudhës së antikitetit të vonë, shek. V, nga ku dalloheshin disa ambiente për magazinimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Pranë këtyre ambienteve u zbuluan edhe rrënojat e një kishë të vogël të po kësaj periudhe dhe një sterë/cisternë për mbledhjen e ujit", thotë Bejko. Është interesante të shohësh se si kohët ritakohen, ndërsa diku pranë gjurmës ku do kalojnë tubat e gazsjellësit, gjen tubacionet e vjetra të ujit. Bejko shton se mbi këto rrënoja, në periudhën osmane, në shek. 17-18 është ndërtuar një kompleks banimi shumë i madh, ku ndër të tjera mund të dallohet një banjë turke/hamam, i cili shërbeente për këtë banesë.

"Përveç ambienteve të banimit, u identifikuan edhe një sërë ambiente ndihmëse dhe magazina. Mendohet se banesa i takonte një familjeje aristokrate të asaj periudhe", thotë ai. Duke nisur nga rëndësia e këtij zbulimi arkeologjik, TAP vendosi të devijojë linjën e gazsjellësit dhe të ruajë të paprekur vendbanimin arkeologjik në fjalë, në hyrje të të cilit një tabelë njofton për zbulimin, ndalon hyrjen e të paautorizuarve. Siti në vetvete është i rrethuar dhe në disa raste arkeologët kanë punuar edhe me krijimin e kanaleve që shmangin erozionin gjatë shirave, duke qenë se pjerrësia është e madhe dhe zona kodrinore paraqet rrezik. Vendimi për devijimin e punimeve, i pasqyruar në faqen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, u bë shkas për të kontaktuar TAP-in me zbulimin, çka çoi në një vizitë të një grupi gazetarësh në sit, për të parë nga afër punën e bërë dhe se si, ligji i trashëgimisë gjen një nga rastet më të mira të zbatimit jo



Pjesë e hamamit në Berat



Absida e shek. V, Fushë Peshtan

vetëm në Fushë-Peshtan, por edhe më tej, siç tregohet nga zbulimet. Hyrja në sit shoqërohet me një "trajnim" të mirëfilltë dhe veshjet e duhura bashkë me një sërë masash sigurie, që i vlejné sa s'itit edhe vizitorëve të parë, kur ai ende nuk është gati të presë.

VARREZAT E NEOLITIT

Në kuadër të vizitës në Berat, ku aktualisht po punohet, Lorenc Bejko, Nevila Molla dhe Arber Kadia paraqesin pothuaj gjithë zbulimet e dala në dritë në kuadër të punimeve për Gazsjellësin Trans Adriatik. Në çdo segment punimi ka pothuaj 20 monitorues, ndërsa para fillimit të punës janë bërë 35 studime paraprake për të shmangur që herët zonat me potencial. Raporte vëzhgimi, sondazhe, gërmime dhe në fund dokumentimi i të gjithave janë proces i përditshëm. Arkeologia Nevila Molla flet për dy varreza

Lorenc Bejko: Dëshmitë e Dersnikut e Beratit dhe shtresëzimet e historisë



Zbulimi "Bregu i hamamit" në Fushë Peshtan, Berat

të dala në dritë në Korçë, një mesjetare e shekujve XIII-XIV me 150 varre dhe një prehistorike pranë Turanit në Korçë. Në këtë të dytën, mes skeleteve të dala në dritë, është edhe ajo e një "nuseje me diademë" - skeleti ka ende mbi kafkë një diademë, çka flet për një grua që i përkiste shtresës së lartë të popullsisë.

Në këto varre janë gjetur shigjeta, kama, qelq - sqaron Molla.

Jo tërësisht me shaka e pyes profesor Bejkon, nëse zbulimi i dalja në dritë e këtyre varrezave në zonën e Korçës do të ndryshojë kursin e historisë? Bejko qesh, dhe mohon.

"Këto zbulime na tregojnë se nuk ishte rastësi që zona u bë qen-

dra politike e mbretërisë ilire. Qeramika kopjon modelin grek, ndërsa Turani paraqitet me rrjet të zhvilluar shkëmbimesh, ka qelbar që vjen nga Estonia për shembull".

Zbulimi Dersnikut është ende më i rëndësishëm sipas Lorenc Bjekos. Bëhet fjalë për një zbulim që dëshmon për 6000 vite më parë. Pranë tij kishte një kanal drenazhimi dhe varret janë gjetur pak të dëmtuara, megjithatë, studimet e deritanishme flasin për dëshmi të rëndësishme të neolitit. "Kemi për herë të parë një fshat neolitik dhe kjo është një mundësi që na e jep TAP ta zbulojmë. Sepse ne aritëm që ta gërmonim të gjithë

zonën, duke nxjerrë në dritë për shkak të përballimit të shpenzimeve nga TAP hapësira të mëdha dhe struktura të mëdha".

Bejko shton se si Ballkan, kemi qenë lider kulturor në kontinent. "Nga këto popullsi indoeuropiane kanë gjenëzën gjuhët tona, ka shumë dimensione. Ndryshon ekonomia - thotë Bejko - duke shtuar se atëherë lindi koncepti i pronës private, i familjes së organizuar, banesat janë të parat e organizuara. Buqësia që gjejmë në Dersnik është fillimi i OMGJ, po këtu e ka filluesën në neolit, sepse filloi modifikimin, duke zbutur delen, derin, dhinë, duke kultivuar grurin e drithërat, nisi të modifikohet".

Është histori interesante, sipas tij. "Është një zbulim i sapopërfunduar, nuk kemi bërë zhurmë për të ende. Nuk ka monumentalitet si zbulim, ka rëndësi për nga përmbajtja. Këtu nis jeta sedentare e shoqërisë. Në këtë rast kemi mundësi për herë të parë ta shohim në shtrirje të gjerë neolitit", thotë Bejko.



Varrezat neolitike në Dersnik, Korçë



Opinion i Ditës

Sa shumë urrejtje e sa pak dashuri mes nesh

Zoje Jakaj, dr. shkencash

(Vijon nga faqja e parë)

... në shpirt, kur e kuptoj ndonjëherë sa pak e vlerësojmë ne dashurinë dhe them me vete pse të mos kishte në këtë vend kurse të veçanta, ku njerëzit të mësonin mbi dashurinë, shkolla të veçanta për të vegjlit që të mësoheshin që të vegjëlsin si të rriten me kulturën e dhënies së mirësisë kudo ku ata ndodhen e kur të rriten, të jenë të gatshëm dhe të përgatitur për t'u përballur me qetësi me problemet, pa kaluar në urrejtje e dhunë, por të jetë rrënjësor me të mësuar brenda karakterit të gjithsecilit. Si të duan veten, jetën, botën që na rrethon, fëmijët, prindërit, miqtë mikeshat dhe termi i ditës të jetë transmetimi i dashurisë. Mbaje kur ta lexoni këtë shkrim ndonjëherë nga ju do thotë me siguri "autori/a nuk është mirë", se në këto kohë të vështira nuk duhet të botosh këtë lloj shkrimi, por pas pak do e kuptojë që jo vetëm është i domosdoshëm ky shkrim, por me këtë prek në ndërgjegje të gjithë ata që kanë humbur sensin e dashurisë njerëzore dhe ua sugjeroj të tjerëve ta lexojnë se shërben për më të mirën e mundshme... Do jetë një veprim i mrekullueshëm t'i largohemi dhunës së fjalës, urrejtjes së transmetuar në gazetë dhe edicione lajmesh, në kryetituj sa u vranë dhe sa u vetëvranë, sa u aksidentuan. A nuk ka ardhur koha që njeriu si qenie e brishtë të vlerësojë veten dhe të mbrojë jetën nga këto stresa e makthe që të sjellin në mendje epidemi lufte dhe jo kohëra paqeje?! Nëse njeriu i zakonshëm përpiqet të gjejë veten, çdo rrugë është vetëm njëri nga drejtimet ndërmjet miliona rrugëve të mundshme që zgjedh, prandaj duhet të kemi parasysh që një rrugë është vetëm në një drejtim dhe duhet të kuptoni të ndiqni drejtimin e duhur, i cili të çon drejt dashurisë për jetën dhe jo drejt dhunës së përjetuar për vete e të përcjellë tek të tjerët. Mendjet e arsyeshme dhe të logjishme shpesh nuk besojnë totalisht në fuqinë e dashurisë dhe përpiqimi ta përkufizojmë si iluzion, opium të mendjes, mendim idealist etj. Kemi dyshime e paragjykimë ndaj teorieve që përpiqen të kërkojnë e të provojnë fuqinë e dashurisë, duke përcaktuar sjelljen e personalitetit njerëzor. Ama, të gjitha na shërbejnë për të kuptuar rëndësinë e të qenit i mirë dhe i dashur, nuk duhet të kënaqemi duke kopjuar shembuj jo të vlefshëm të personalitetit njerëzor, por të luftojmë e të përsosim vetveten. Një person i pasur me dashuri ka çfarë të tregojë gjithnjë, edhe kur nuk është ak-



Një person i pasur me dashuri ka çfarë të tregojë gjithnjë, edhe kur nuk është aktiv në dhënien e kësaj ndjesie të veçantë, është unikal dhe përpiqet të ruajë e transmetojë mirësinë e dhënies së dashurisë. Për njeriun, gjëja më e madhe që ka është jeta dhe deri sa jemi gjallë, ka edhe shpresë - thotë një fjalë e vjetër.

tiv në dhënien e kësaj ndjesie të veçantë, është unikal dhe përpiqet të ruajë e transmetojë mirësinë e dhënies së dashurisë. Për njeriun, gjëja më e madhe që ka është jeta dhe deri sa jemi gjallë, ka edhe shpresë - thotë një fjalë e vjetër. Te zgjedhësh jetën nuk është kaq e vështirë sa kujtojmë, e megjithatë janë të shumtë ata që nuk dinë të zgjedhin rrugën e drejtë, atë të dashurisë, paqes, ndihmës së të tjerëve,

humanizmit dhe perfeksionit të figurës njerëzore... Po ju ofroj disa përkufizime: "Jeta është e bukur, e duhet t'i gëzohemi asaj". "Jeta është cilësi që e dallon një qenie të gjallë". "Jeta është ajo periudhë në të cilën njeriu ia di vlerën dashurisë, lutjes dhe paqes". "Një ditë të gjithë do ikim, është mirë të mbahejm mend dhe të kujtohem me shumë dashuri". "Dua që dashuria do të të mbushë çdo

boshllëk, që vetë jeta të krijoj zgjedhjen e rrugës së duhur. Edhe nëse kjo rrugë e juaja kalon nëpër shtigje të errëta apo sakrificë të mëdha, ia vlen të jetosh me dashuri dhe ta transmetosh atë në ambientin ku ti punon dhe jeton". Larg gjuhës së urrejtjes se po i helmojmë fëmijët tanë me dhunën verbale të fjalës e po rrisim të rinjtë të ashpër. Është koha të vëmë alarmin për më shumë paqe e mirësi në mesin tonë.

HOROSKOPI

DASHI

Lërimi dashurinë që të rrjedhë lirish. Do të shërbejë për të çimentuar një lidhje të konsoliduar, ose të shkrijë ndrojtjen në një marrëdhënie të porsalindur. Do t'ju duhet të pranoni disa kompromise. Solidariteti është i barasvlershëm me suksesin e ndërmarrjeve.

DEMI

Humori juaj sot është i lidhur me melankolinë e ditës, me planetët që nuk janë shumë në favorin tuaj. Do të keni apati dhe mungesë motivimi për të punuar. Për t'ju ngushëlluar, do të keni shumë miq të singertë që ju mbështesin.

BINJAKET

Me mbështetjen e shumë planetëve në harmoni, dita fillon me mbarësi. Të arrini objektivat tuaja do të jetë një lojë fëmijësh. Një takim i papritur me një mik të vjetër do të bëjë që të ndryshoni planet për mbrëmjen.

GAFORJA

Në përgjithësi jeni të përkushtuar, por vullneti i personit që keni në krah ndërhyn për të ndryshuar gjërat, duke bërë që t'ju ndryshojë programin. Do të keni edhe zënkë në çift, me grmëzje të lodhshme për të përcaktuar se kush do të imponojë vullnetin e vet.

LUANI

Ditë me fat! Të ndihmuar nga bashkëpunimi i Hënës, Venusit, Marsit dhe Uranit jeni në një pozicion mbarësiel! Do të ketë një shans edhe për ata që nuk pëlqejnë vetminë. Ndoshka nuk do të gjeni shpirtin binjak, por dikë që është pak a shumë astu i tillë.

VIRGJERESHA

Të kapur nga doza të vogla dembelizmi është një "luks i nevojshëm" por nëse e teproni, mund të humbni të gjithë ditën dhe mund të pendoheni shumë të nesërmen. Plutoni, i cili ju mbështet prej shumë vitesh, do të vazhdojë të jetë një mik i vetëm dhe i vërtetë. Ndërkaq, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për vjet e tjera.

PESHORJA

Ditë për t'u mbajtur mend, ku të gjithë do të jenë kundër një-tjetrit: ju, partneri, fëmijët, kunetërit dhe prindërit. Dhe kështu do të ketë një mori hatërmbetjesh dhe bashkëbisedime ironike. Edhe një marrëveshje ndër aksionare mund të prishet, ju shkaktoni polemika, ndërsa të tjerët reagojnë keq.

AKREPI

Kjo është dita ideale për të lënë mënjana gjërat që nuk shkojnë në fushën profesionale dhe të përgatiteni për një ndryshim të qenësishëm të strategjisë ose objektivave. Ndërkohë, shmangni të menduarit e gjërave shumë të mëdha dhe matini mirë mjetet dhe burimet që keni në dispozicion.

SHIGJETARI

Nuk jeni nga ata që lini t'ju ikë një mundësi për t'u dëfruar, sidomos kur një Hënë e zjarrit dhe e hareshme ju thërrret të argetoheni. Kështu, pavarësisht nga barra e angazhimeve të ditës që kemi, do të bëni gjithçka për të pranuar ftesën për argëtim.

BRICJAPI

Më mirë t'i lëni gjërat ashtu siç janë sot që planetët nuk janë shumë të favorshëm dhe ju provokojnë hapur, duke bërë që të humbini kohë të çmuar. Është e vërtetë që jeni jashtëzakonisht të duruar, por çdo gjë ka një kufi.

UJORI

Do të jetë një ditë emocionuese dhe me shumë zhurmë. Yjet ju shtynë që të dilni, të takoni njerëz të rinj, të argetoheni dhe të zbuloni botën e kulturës. Është ditë ideale për të organizuar një udhëtim qoftë për punë, qoftë për kënaqësi.

PESHQIT

Sot do t'ju duhet t'i përsheptoni gjërat, sidomos nëse fitimi vjen menjëherë. Bëni kujdes me shpenzimet, pasi do të keni dëshirë të kryeni shumë blerje sot. Megjithatë, nëse vendosni të bëni blerje të mëdha, tregohuni të zgjuar në zgjedhje.

Opinioni *i* Ditës

Julian Zyla

(Vijon nga faqja e parë)

"Tahiri", si shembull i një manie të opozitës

... të një interviste të gjatë televizive. Gjatë asaj dite, kur arrestimi i Saimir Tahirit po dukej çështje orësh, shumëkush, përfshi gazetarin Fevziu, mendonte se PS e kishte braktisur deputetin e saj përfundimisht.

Por, në mbledhjen e Këshillit të Mandateve dhe nga deklarata politike që e paraprindë dhe e pasuan nga të dyja palët, u kuptuan dy gjëra: 1) Dosja "Tahiri" i kaloi politikës dhe më shumë se dikush nga i cili duhet mbajtur distancë, Saimir Tahiri po duket fushëbetja politike e radhës dhe kjo nuk do të ndryshojë nga arrestimi i tij i mundshëm. 2) Edhe këtë herë opozita, qoftë me vete, qoftë e bashkuar nuk arriti t'i shpëtojë manisë së saj të ekzagjerimit politik, edhe atëherë kur ndoshta nuk ka nevojë.

Në vitin 1998, republikanët amerikanë arritën të nxirrin Bill Clinton në gjyqin e legjislativit pas një skandali seksual, nën akuzat për dëshmi të rreme dhe pengim të drejtësisë. Ata kishin shumicën e sapokonfirmuar në të dyja dhomat e Parlamentit dhe kërkimin shkarkimin e Presidentit. Këtë vendim duhet ta merrte Senati, ku republikanët kishin 55 senatorë, ndërsa demokratët 45 senatorë, por duheshin 67 vota ose dy të tretat e Senatit. Demokratët vendosën ta mbrojnë Presidentin dhe çështja u konsiderua prej tyre politike. Kështu, vetëm 50 senatorë ishin në fund pro shkarkimit të tij mbi akuzën për pengim të drejtësisë dhe vetëm 45 mbi akuzën për dëshmi të rreme. Për të dyja akuzat



demokratët votuan të gjithë kundër.

Çështja "Tahiri" është tashmë në duart e politikës, e ndarë në linja partiake. Kjo nuk nënkupton patjetër që Parlamenti nuk do t'ia heqë imunitetin, por kjo mundësi tashmë nuk mund as të përjashtohet. Gjithashtu, edhe në rastin e heqjes së

imunitetit dhe të arrestimit të tij, me ndihmën e PD, çështja ka marrë ngjyrat e një beteje politike.

Situata delikate për Partinë Demokratike është se sa më shumë të kërkojë arrestimin e deputetit, aq më shumë thekson ngjyrat politike të çështjes dhe cinikët mund të dyshonin edhe për rolin e tyre

në këtë çështje që duhet t'i takojë vetëm drejtësisë. Në anën tjetër, prokuroria e para - Reforma nuk ka besueshmëri të mjaftueshme për të bindur shqiptarët se po bëjnë punën e tyre si të papolitizuar që duhet të jenë.

Por le të kalojmë tek aspekti më i ngushtë politik: mania e opozitës

për të ekzagjeruar dhe për të kërkuar "impeachment" të kryeministrit si zgjidhjen e çdo ngjarjeje politike. Basha ka kërkuar dorëheqjen e Ramës për armët kimike, ka kërkuar dorëheqjen e Ramës për akuzat për ekonominë, ka kërkuar dorëheqjen e Ramës para zgjedhjeve dhe kërkon dorëheqjen e Ramës tani pas zgjedhjeve.

Përpara zgjedhjeve, PD shkruante "Shqipëria Ngrihet" në sfondin e deklaratave për shtyp të përfaqësuesve të saj. Pa dyshim kishin pakënaqësi në publik për disa çështje dhe PD kishte arritur të organizonte disa protesta muaj më parë. Por, protestat kishin mbaruar dhe njerëzit ishin të gjithë në shtëpi. Ekzagjerimi jepte efektin e kundërt politik për Partinë Demokratike. Ndërkohë që shqetësimet që ngrinin mund të ishin të vlefshme, pesha që u jepnin ishte në disproporcion me perceptimin real të tyre nga njerëzit.

Edhe për çështjen "Tahiri", mania e ekzagjerimit politik e z. Basha është në funksion sa herë që i jepet mundësia. Në këtë praktikë duket se po i bashkohet edhe opozita e (pabashkuar). Të gjithë jo vetëm që kanë shpallur Tahirin fajtor përpara se t'i hiqet imuniteti, por kërkojnë dorëheqjen e Ramës. Pra, ky është synimi, e jo funksionimi i drejtësisë?!

Nuk po sugjeroj që Lulzim Basha t'i bashkohet Tahirit dhe Fevziut në kafe, por rezultatet politike me ekzagjerimin dhe ngritjen e zërit duhet ta bëjnë z. Basha të rimendojë strategjinë e tij. Çështja "Tahiri" është një mundësi.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Drejtori sportiv i të kuqve, italiani Antonelo Preiti, beson te zgjedhjet e trajnerit Iuliano

Preiti: Fitojmë në Shkodër dhe largojmë krizën

Partizani me mungesa në sulm. Jashtë Çani e Sukaj



Jeton Selimi

Antonelo Preiti beson se Partizani do të vijojë me rezultatet pozitive edhe në ndeshjen e Shkodrës, ku të dielën do të jetë mysafir i Vllaznisë në "Loro Boriçi". Ndonëse të kuqtë do të vuanë mungesën e dy sulmuesëve titullarë si Çani dhe Sukaj, drejtori italian beson se Iuliano do jetë në gjendje ta zgjidhë ngërçin e sulmit. Në intervistën dhënë për rubrikën "Sport-News", Antonelo Preiti deklaroi se vetëm rezultatet pozitive do bëjnë që kriza e Partizanit të marrë fund.

Drejtor Preiti, pas një nisjeje të vështirë kanë ardhur dy fitore radhazi. Tani vjen një ndeshje e delikate në Shkodër me Vllazninë. Çfarë mund të presim nga ekipi sa i takon rezultatit dhe lojës?

Sa i takon rezultatit, shpresojmë që të zgjasim serinë e fitoreve pas këtyre dy ndeshjeve të fundit. Çdo ndeshje është e vështirë dhe duhet përballuar në mënyrën e duhur dhe ndaj shkujmë në Shkodër të vetëdijshëm se jemi në gjendje të bëjmë mirë dhe të marrim një rezultat pozitiv. Sa i takon lojës, shpresojmë që të rritemi siç bëme të hënën, ku bëme një paraqitje më bindëse se në takimet e tjera. Skuadra është në rritje, por i përthith mirë direktivat e trajnerit dhe veç mund të presim një rritje.

Është gjendje emergjente në sulm. Çani nuk është, Sukaj u dëmtua. A janë në gjendje Basrak e Xhixhua të mbajnë



peshën e sulmit?

Repartit ofensiv është ai që ka pasur më shumë vështirësi që nga fillimi i sezonit të diktuar nga dëmtimi i Çani dhe tani i Sukajt. Basrak erdhi nga një dëmtim. Të hënën hyri në 20 minutat e fundit dhe bëri gjëra të mira. Trajneri do të bëjë zgjedhjet e tij mes Basrakut, Xhixhhuas dhe Bardhit. Të dielën sulmi do të jetë pa Çani dhe Sukajn, ndaj do të shpresojmë që lojtarët e rinj të shfrytëzojnë më së miri shanset që trajneri do t'u japë.

Pas dy fitoreve radhazi a është skuadra më e çliruar psikologjiksht? Sepse me fillimin jo të mirë të sezonit, u përfolën shumë dhe situatë të tjera

në lidhje me klane të mundshme brenda ekipit.

Kur vijmë rezultatet edhe mendja çlirohet. Është një skuadër që luan bashkë që prej 10 gushtit me përfshirjen e lojtarëve të rinj, si të huaj, por po ashtu edhe shqiptarë si Progni apo Kotobelli, që ishin të rinj në këtë grup. Nuk ishte e lehtë, sepse me marrëritjen e rezultateve vihen re më shumë hijet sesa gjërat e bukura. Por është një grup i bashkuar, një grup serioz. Mbase flitet më shumë jashtë se brenda në lidhje me klane sa u takon lojtarëve vendës dhe atyre të huaj. Në situatë të tilla është e lehtë të akuzosh për diçka që nuk shkon. Kemi nevojë vetëm për rezultatet sepse rezultatet janë ilaçi

më i mirë për të kuruar situatat.

Në fillim të sezonit u tha se objektivi i Partizanit është titulli kampion. Tani Skënderbeu është shkëputur në krye. Sa është në ngushtë kjo skuadër që të ngushtojë hendekun me kreun?

Është në gjendje nëse merr rezultate pozitive. Në këto dy ndeshjet e fundit ka treguar se është në gjendje që të garojë për titullin. Sigurisht që ka skuadra që po luajnë fort, siç është edhe ekipi i Korçës që po bën mirë. Por pavarësisht asaj që po bëjnë të tjerët, ne do të mendojmë për veten tonë. Ndaj nëse dua që në fund të sezonit të arrijmë gjëra të rëndësishme, duhet të fitojmë.

POST SKËNDERBEU-PARTIZAN BEOGRAD

Stojkoviç: Elbasani? Është më keq të luash në Novi Pazar

Mikpritja e tifozëve shqiptarë dje në mbrëmje i ka habitur serbët. Portieri i Partizanit të Beogradit, Vladimir Stojkovic ka treguar atmosferën e kësaj ndeshje, duke e përshkruar si shumë të qetë. "Sinqerisht është më e vështirë që të luash në Novi Pazar se sa në Elbasan. Ishte një ndeshje normale, e fortë njëlloj si një ndeshje e kampionatit. Mendoj se më shumë atmosferë ka në Novi Pazar, u shpreh ai. Portieri i ekipit serb u kthye me një pikë nga Shqipëria, teksa e ka cilësuar si një rezultat të mirë. "Kishim disa mundësi për të fituar 3 pikë. Besoj se do t'i fitojmë dy ndeshjet që do të luhen në Beograd. Shpresojmë që të fitojmë ndaj Skënderbeut dhe më pas të sigurojmë kualifikimin me një fitore ndaj Young Boys", -u shpreh portieri i njohur për mediat serbe.

Jashanica zë vend në formacionin e javës në Europa League

Pas zhvillimit të ndeshjeve të djeshme në grupet e Ligës së Europës, sot faja zyrtare në internet e UEFA-s ka publikuar formacionin më të mirë të kësaj jave. Mes futbollistëve të përzgjedhur në bazë të performancës së tyre, bën pjesë edhe mbrojtësi i Skënderbeut, Bajram Jashanica. "7 ndërhyrje, 5 duele ajrore të fituara dhe 4 spastrime të zonës ishin disa nga statistikat e tij impresionuese në mbrojtje", -thotë përshkrimi për Jashanicën, i cili arsyetonte zgjedhjen në formacionin e javës.

Mediat serbe kritikojnë lojën e Partizanit të Beogradit

Pasi u mundua të krijonte "stuhinë në një gotë uji", duke shkruar për një skandal në Elbasan, shtypi serb është marrë edhe me lojën e Partizanit të Beogradit në ndeshjen e mbrëmshme me Skënderbeun. "Kurir" shkruan se Partizani vazhdon të mos fitojë në Europa League dhe se në ndeshjen e "Elbasan Arenës" ishte sulmi pika më e dobët. Më së shumti, kryqëzohet sulmuesi Soumah, i cili kishte një rast të mirë në zonë, por gjuajtja e tij u ndal nga Shehi. Përmenden, po ashtu, pritja e Shehit ndaj Tosçit nga një goditje dënimi dhe shtylla e Miletit në kohën shtesë.

Dridhet pankina e Montelës, ja teknikët e lirë që presin shkarkimin

MILANI

Pas barazimit në ndeshjen e së enjtes në Ligën e Evropës në "San Siro" kundër AEK-ut, pankina e Vincenzo Montelës është në dyshim të madh. Pas fjalëve të Marko Fasones dhe Massimo Mirabelit që i dolën në mbrojtje teknikut të "djallit" pas humbjes në derbi kundër Interit të dielën e shkruar, duke deklaruar që Milani nuk po kërkon trajner tjetër. Por në ditën e djeshme, sipas mediave të ndryshme sportive italiane, "shpëtimi" i vetëm i Montelës mbetet sfida e së dielës në kam-



pionat kundër Xhenoas. Ndërkohë mediat italiane kanë zbardhur një listë prej 9 teknikësh që janë aktualisht pa kontratë dhe Milani mund të jetë e gatshme t'i kontaktojë në rast dështimi përsëri në ndeshjen e ardhshme. Ndër ta ka edhe emra

"Big" të teknikëve si Karlo Anceloti, Luis Enrique, Thomas Tuchel, Laurent Blanc, gjithashtu, edhe Marko Van Basten. Por nuk mbeten pas edhe teknike si Valter Maxarri, Paolo Sousa, Massimo Odo dhe Françesko Guidolin.

TRAJNERI I ARGJENTINËS

Diego Peroti ftohet në kombëtaren e Argjentinës për miqësoren kundër Rusisë që do të luhet më 11 nëntor. Trajneri Sampaoli ka thirrur mesfushorin me tipare sulmuese që aktivizohet te Roma për këtë përballje testuese. Peroti regjistron vetëm dy prezenca me Kombëtaren e Argjentinës, e fundit në miqësoren kundër Nigerisë më 2011-ën. Surprizë është padyshim lënia jashtë liste e Gonzalo Higuain. Trajneri i Argjentinës nuk e ka ftuar sulmuesin e Ju-


Habit Sampaoli: Lë jashtë Higuain në një ndeshje miqësore



ventusit për ndeshjen kundër Rusisë. "Nuk mendoj se çështja 'Higuain' ka rëndësi për momentin. Grumbullimin e tij mund ta marr parasysh në të ardhmen", -tha trajneri Jorge Sampaoli duke lënë të hapur derën për grumbullimin e

sulmuesit të Juventusit në kombëtaren e Argjentinës. Ndërkohë që kthehet në ekipin përfaqësues të Argjentinës edhe Sergio Aguero, sulmuesi i Manchester City-t që nuk u grumbullua në sfidat e fundit për shkak dëmtimi.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotuarat.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkrdran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Entë Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akiilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Unë i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktoe.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.
35. Mbyllin një ditat.

VERTIKAL


36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshhtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Eshhtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermene.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lufjes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicialet e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë trysni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktor.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelilit.
40. Janë take në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	4	9	1	7		8		
6	2				9	4		
	7			4			3	
	8		5		3		9	
5		3		2			6	
1	4		6			2		
9		6				1		
	8	2				3	7	
	2		1	3	5	9		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9



Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	1	6	2	3	8	5	7	9
5	3	8	7	4	9	1	6	2
2	7	9	5	1	6	3	4	8
6	8	1	3	2	7	9	5	4
7	9	4	8	5	1	2	3	6
3	5	2	9	6	4	7	8	1
9	6	3	4	7	2	8	1	5
1	2	5	6	8	3	4	9	7
8	4	7	1	9	5	6	2	3

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Argëtim filozofik

"Koha jote është e kufizuar, kështu që mos e humb atë duke jetuar jetën e dikujt tjetër. Mos bjer në kurthin e dogmave, që do të thotë të jetosh me rezultatet e mendimeve të tjerëve. Mos e lejo zhumën e opinionëve të tjerëve të fundosë zërin tënd brendësor. Dhe më e rëndësishmja, kij guximin për të ndjekur zemrën dhe intuitën tënde. Ato tashmë dinë se çfarë dëshiron të bëhesh me të vërtetë. Gjithçka tjetër është dytësore..." Steve Jobs

Thënie të mençura

- Pjekuri do të thotë të dish të bësh gjëra, për të cilat nuk na kontrollon askush: të kesh lekë në xhep dhe të mos i shpenzosh ato, të të bien në qafë dhe të mos duash të hakmerresh.
- Nuk është e vështirë të ngjitesh në majë. E vështirë është të qëndrosh gjatë atje.
- Claude Debussy Kompozitor (1862-1918)
- Disa vese po të përdoren mirë, shkëlqejnë më shumë se virtyti
- La Rochefoucauld Shkrimtar (1613-1680)

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

HORIZONTAL

1. MUND TË JETË KURSIMI
5. YLLI I NOSTRADAMUS
8. TAMAM PA KUFIJ
11. ROSS KËNGËTARE
13. I LASHTË
15. ESHËTË ALEANCA KU SAPOI KEMI ADERUAR
19. KUFJTË E LËVIZJES
20. I KA TEK PLEPI
21. PAGUHEN PËR SHËRBI
23. FILLOJNË LEJEN
24. KUFIZOJNË TROTUARAT
25. BËJNË KARRIERË NË PARTI
27. THAHET ME BONIFIKIM
28. MUND TË JETË UNIK NJË I TILLË
29. PREKA KOMIK SHKDRAN
31. FUND DHJETORI
32. FILLOJNË AKSIONIN
33. ENTË OPERATIVE TIRANË
34. AGJENCI AJRORE DURRËS
36. NJË PJESE E DIMENSIONEVE

VERTIKAL

1. SI I PËRSHTATËSHËM
2. MUND TË JENË FETARE
3. AI I KUQ E KA NJË HUQ
4. PAK ANALOGJI
6. ESHËTË METRI I RROBAQEPËSIT
7. NË HYRJE TË OAZIT
8. ARTE PA RE
9. ARTHUR QË QE DRAMATURG
10. JANË BOSHTË
12. MICHELANGELO REGJISOR
14. MUND TË BËJË STIL TË LIRË
16. ISHIN MONEDHE TE TOBIAS
17. ESHËTË BAS ME KATËR TELA
18. PAK EFIKASITET
22. ESHËTË MARRËVESHJE ME NOTA
25. ISHTE BABAI I AKILIT
26. FILLOJNË NAZET
27. NË KRYE TË KUADROVE
29. ESHËTË FAQE MURI
30. NJË APENDISIT I MENJËHERSHËM
35. KUROSAWA QË QE REGJISOR
36. VRITEN NGA ESPADA
37. ESHËTË SHTET AZIATIK
38. EDOUARD PIKTOR
40. NJË TRANSPORTI ËSHËTË KAMIONI
45. UNË I FREUD
46. NJË CIGAN
47. FUNDI I NJË SAMURAI

FJALËKRYQI (2)

HORIZONTAL

1. FILLOJNË PANIKUN
3. GIBSON AKTOR
5. NË MES TË COGITO DHE SUM E THËN NGA DESCARTES
9. MUND TË JETË TROFE
11. JANË VENDET SI KATARI
14. MAUREEN QË QE AKTOE
16. JANË KUNDËRMUESE
17. MUND TË FITOJNË ETAPA
20. USHTOJNË NGA "OLA"
22. NJË THIRRJE
26. JANË MINISTRITË
27. NJË RRUGË NË PARIS
28. MARKË CIGAREJE
29. ESHËTË NGJINJA
32. RICCIARELLI SOPRANO
33. FILLOJNË SEFTE
34. ENTE EKONOMIKE SARANDË
35. MBYLLIN NJË DITAT

VERTIKAL

36. SATELIT I JUPITERIT
37. I KA TEK LUANI
38. BOLDI KOMIK ITALIAN
42. ESHËTË KOLANA NË FILMA
43. KUSH E THOTË LUTET
44. OXA KËNGËTARE
46. INICIALET E NOLTE AKTOR
47. ESHËTË TOKË QË... FITOHET
48. NJË... GJERMENE
9. ISHIN KOMITË
10. KA KRYEQYTET ISLAMABAD
12. DON... I INTERPRETUAR NGA TERENCE
13. MBYLLIN AKTET
15. JANË PËRMASA
18. GJYSMA E LUFJES
19. CASTELLITTO AKTOR
20. INICIALET E DALÍ, PIKTOR
21. TANITA KËNGËTARE
23. ESHËTË TRYSNI
24. NË HYRJE TË EUROPËS
25. JANË RROBAT PËR T'U LARË
30. BËN MËZA
31. MOREAU AKTOR
32. JANË THIKA
39. NJË PJESE E SATELITIT
40. JANË TAKE NË SENDE
41. PAK MARRAMENDËSE
42. I KA TEK ZDAPI
45. INICIALET E NOLTE-S

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

